

**MARK FISHER**

# **MILIONERI**

***SEKRETI I ARRITJES SË  
SUKSESIT TË PËRGJITHSHËM  
DHE FINANCIAR***

Shqipëroi:  
***Hasan Hamëzbalaj***

**Titulli i origjinalit**  
**Mark fisher – *The instant Millionaire***  
***(A Millionaire reveals how to achieve***  
***personal and financial success)***

**Lektorën-korrekturëm:**  
***Fisnik Kroi***

# **PËRMBAJTJA**

## ***Kreu 1***

***Djaloshi e kërkon këshillën e dajës së pasur***

## ***Kreu 2***

***Djaloshi e takon kopshtarin plak***

## ***Kreu 3***

***Djaloshi mëson sesi shfrytëzohen rastet dhe si i  
hyhet rrezikut***

## ***Kreu 4***

***Djaloshi ndihet i robëruar***

## ***Kreu 5***

***Djaloshi mësohet të besojë***

## ***Kreu 6***

***Djaloshi mëson sesi të përqendrohet në qëllimin***

## ***Kreu 7***

***Djaloshi njih vlerën e imixhit të vet***

## ***Kreu 8***

***Djaloshi zbulon fuqinë e fjalës***

***Kreu 9***

***Djaloshi për të parën herë e vëren zemrën e trëndafilin***

***Kreu 10***

***Djaloshi mësohet ta zotërojë ndërdijen e vet***

***Kreu 11***

***Djaloshi dhe mentori i tij diskutojnë për numrat dhe formulat***

***Kreu 12***

***Djaloshi mëson për fatin dhe jetën***

***Kreu 13***

***Djaloshi mëson t'i shprehë dëshirat e veta***

***Kreu 14***

***Djaloshi zbulon fshehtësitë e kopshtit me trëndafila***

***Kreu 15***

***Djaloshi dhe plaku shkojnë rrugëve të ndryshme***

**Epilogu**

*Për çdo ditë, në çdo aspekt, po përparoj  
gjithnjë e më shumë.*

**EMIL KUE, mjek francez**

*Mark Fisher është milioner i ri kanadez i cili merret me pasuritë e patundshme dhe me botime.*

*Suksesi, ndërkaq, nuk varet prej asaj se çfarë punoni në jetë, por si e punoni atë.*

*Të gjithë mund t'i realizojmë qëllimet tona personale dhe financiare nëse i kuptojmë parimet e suksesit dhe i zbatojmë ato në praktikë.*

*Pikërisht për këtë arsye edhe është shkruar ky libër, i cili deri tash është përkthyer në shumë gjuhë, duke përhapur nëpër tërë botën tregimin për Instant Milionerin.*

## KREU 1

### **Djaloshi e kërkon këshillën e dajës së pasur**

Na ishte njëherë një djalosh i zgjuar i cili dëshironte të pasurohej. Kishte përjetuar shumë dëshpërime dhe mossuksese, por akoma besonte në yllin e fatit të vet.

Duke pritur që t'i buzëqeshte fati, ka punuar si ndihmës kontabilisti në një agjenci të dorës së dytë për reklama. Nuk ka qenë i kënaqur me rrogën dhe një kohë tepër të gjatë e ka ndier se atë punë më nuk po e donte.

Ka ëndërruar që të punonte diçka tjetër, ndoshta që të shkruante roman i cili do ta bënte të pasur dhe të famshëm e i cili njëherë e përgjithmonë do t'ia zgjidhte problemet e tij financiare. Por, a thua vallë ajo ambicie e tij nuk ishte ngapak joreale? A ishte, vallë, ai vërtet mjaft i talentuar dhe a i njihite teknikat e shkrimit të bestselerëve apo faqet e zbrazëta do të përmbusheshin me tollovinë e mjerimit të vet të brendshëm?

Puna i ishte bërë ankth nate. Memzi e duronte shefin i cili shumicën e paraditës së vet e kalonte kryesisht duke lexuar gazeta apo duke shkruar diçka, para se t'i përkushtohej drekës së vet triorëshe. Shefi i tij, përpos kësaj, e kishte ngritur gjer në përsosmëri artin e ndërrimit të mendimeve dhe të dhënies së urdhrave të padobishëm kundërthënës.

Por, çështja nuk ishte vetëm te shefi... për fat të keq, ka qenë i rrethuar me kolegë të cilëve iu dilte boll puna e vet. Dukej sikur asgjëje nuk i gjenin kuptim dhe se plotësisht ishin çarmatosur. Nuk gjykonte që kujtdoqoftë t'ia zbulonte dëshirën e tij që të hidhte çdo gjë e të bëhej shkrimtar. E dinte se ajo vetëm do të shkaktonte përqeshjen e rrethit. Ishte i izoluar nga bota, sikur të ndodhej në ndonjë vend të huaj gjuhën e të cilit nuk e dinte.

Të hënën në mëngjes gjithnjë e pyeste veten sesi do ta mbijetonte në zyrë javën në vazhdim? Ndiante antipati të tmerrshme ndaj letrave të cilat grumbulloheshin mbi tavolinën e tij të punës, sipas nevojave të klientëve të tij të cilët bujshëm i shitnin cigaret e tyre, automobilat e tyre, birrat e tyre...

Gjashtë muaj më heret e ka shkruar letrën përmes së cilës jepte dorëheqje nga puna. Disa herë ka shëtitur nëpër zyrën e shefit me atë letër me qëllim që ta linte mbi tavolinë, por kurrë nuk ka qenë krejt i gatshëm që këtë ta bënte. Qesharake, disa vite më herët nuk do të ishte lëkundur. Por tash nuk ishte i sigurt se çfarë duhej bërë. Diçka e ndalonte, një forcë – apo thjesht kjo ishte qyqarllëk? Si duket e ka humbur guximin i cili në të kaluarën gjithmonë i ka dhënë forcë ta bëjë atë që ka dëshiruar.

Ndoshta – shkaku i asaj se shumë gjatë ka pritur që “të vijë ora” dhe se justifikimin për të mos u nisur në aksion e ka gjetur në frikën se nuk do të ketë sukses – është shndërruar në ëndrrimtar të përjetshëm.



Mos vallë shkaktarët e demoralizimit preheshin në borxhet e tij kronike? Apo kjo thjesht ishte nga shkakut se ishte plakur (proces tek i cili vihet domosdoshmërisht në atë çast kur njeriu heq dorë të shikojë kah ardhmëria)?

Dorën në zemër, nuk e ka ditur se ku është problemi. Dhe kështu, një ditë, duke ndier pengesë të jashtëzakonshme, papritmas i është kujtuar daja i cili – çfarë coincidence – ka qenë milioner. Daja ndoshta do të mund t’i jepte ndonjë këshillë apo, edhe më mirë, ndonjë para.

I njohur për ngrohtësinë dhe gjentilencën e vet, daja menjëherë ka pranuar që të takoheshin, por ka refuzuar që t’i huazonte para, me insistimin se ashtu nuk do t’i bënte shërbim të mirë.

“Sa vjet ke?”, e ka pyetur pasi e ka dëgjuar tregimin e tij të pikëllueshëm.

“Tridhjet e dy”, si me frikë ka pëshpëritur djaloshti, duke e ndier fare bukur se pyetja kumbonte si qortim.

“A e di ti se Xhon Pol Geti ka pasur njëzet e tri vjet kur e ka fituar milionin e vet të parë? Dhe po të isha unë në vitet e tua veçse do ta kisha gjysmë milioni. Si është e mundur atëherë që ti në këto vite të jesh i detyruar të marrësh të holla hua?”

“Këtë dhe unë nuk po e kuptoj. Po punoj si milingona, ngandonjëherë edhe më shumë se pesëdhjetë orë në javë...”

“A beson vallë se puna e rëndë i bën njerëzit të pasur?”

“Mendoj... gjithsesi, kjo është ajo në të cilën më kanë mësuar të besoj.”

“Sa fiton në vit... pesëmbëdhjetë mijë funta?”

“Po, për afërsisht aq”, është përgjigjur djaloshi.

“A mendon se dikush që i fiton njëqind e pesëdhjetë mijë funta punon brenda javës dhjetë herë më shumë se ti? Natyrisht se jo! Kjo fizikisht nuk është e mundur – java fatkeqësisht i ka vetëm 168 orë. Ai person fiton dhjetë herë më shumë se ti, e nuk punon më shumë se ti, gjë që don të thotë se punon tjetërdrysh prej teje. Sigurisht ekziston ndonjë sekret për të cilin ti nuk je i vetëdijshëm.”

“Siç duket po.”

“Për fat që këtë po e kupton. Shumica e njerëzve madje as këtë dot nuk e kuptojnë. Ata aq janë të zënë duke u munduar që të fitojnë për jetë saqë nuk arrijnë as të ndalen e të mendojnë për atë sesi të lirohen nga problemet e veta financiare? Njerëzit, shumica, nuk e harxhojnë madje as një orë kohë për të menduar sesi do të mund të bëheshin të pasur, prandaj dhe kurrë në këtë nuk kanë pasur sukses.”

Djaloshi është detyruar ta pranojë se përkundër ambicies së madhe dhe ëndrrës për t’u pasuruar, as ai kurrë nuk është ndalur që me themel të mendojë për situatën e vet. I është dukur se gjithçka e ka ndaluar për këtë, duke e penguar që të ballafaqohet me këtë detyrë, e cila sigurisht ka qenë më e rëndësishmja.

Daja i djaloshtit ka heshtur një kohë, e pastaj e ka shikuar të nipin në sy dhe me buzëqeshje të lehtë, edhe pse ironike, i ka thënë: “Dëgjo, kam vendosur të të ndihmoj. Po

të dërgoj tek njeriu i cili mua më ka ndihmuar të pasurohem. Atë e quajnë Instant Milioneri. Ndoshta ke dëgjuar për të?”

“Jo, kurrë”, është përgjigjur djaloshi.

“Ai këtë emër e ka zgjedhur vetë, sepse pohon se është bërë milioner brenda natës, por vetëm pasi e ka zbuluar sekretin për këtë. Ai pohon se secilit do të mund t’i ndihmonte të bëhet milioner brenda natës – apo, së paku, që ta arrijë mentalitetin e pasanikut. Por, më thuaj – a dëshiron ti vërtet të bëhesh pasanik?”

“Më shumë se çdo gjë bë botë.”

“Ky është kushti i parë. Më i madhi. Por, kjo nuk mjafton. Po ashtu duhet të dish si.”

Djaloshi lehtësisht i ka rrudhur krahët, duke e bërë të ditur se po pajtohej.

Daja e ka shtrirë hartën e madhe në mur dhe ka shënuar qytezën e vogël, madje disi si e vetmuar...

“Këtu jeton ai. A ke qenë ndonjëherë këtu?”

“Jo.”

“Pse nuk provon? Shko dhe gjeje atje. Ai ndoshta do të ta tregojë sekretin. Jeton në shtëpinë e tejmrekullueshme – më e bukura në tërë qytetin. Do të mund ta gresh pa problem.”

“Pse thjesht nuk po ma tregon sekretin – këtu dhe tash? Atëherë nuk do të kisha nevojë të shkoja atje.”

“Nga shkaku se nuk kam të drejtë për këtë. Kur Instant Milioneri ma ka besuar sekretin, gjëja e parë të cilën e ka kërkuar nga unë ka qenë që të betohem se kurrë askujt

nuk kam për t'ia thënë. Ndërkaq, më ka thënë se të gjithëve mund t'iu tregoj se prej kujt e kam dëgjuar.”

Djaloshi krejt kjo i është dukur befasuese dhe e komplikuar, por e xiglonte.

“A je i sigurt se asgjë nuk mund të më tregosh?”

“Absolutisht i sigurt. E vetmja gjë që mund të bëj është që ngrohtësisht të ta rekomandoj Instant Milionerin.”

Pa menduar më tej, daja, nga syza e tavolinës masive prej frashëri, ka nxjerrë një copë letër të pastër, ka marrë lapsin dhe në shpejtësi ka shkarravitur disa radhë. Atëherë letrën e ka thyer, e ka futur në kovertë, e ka vulosur dhe me buzëqeshje ia ka dorëzuar të nipit.

“Këtu është rekomandimi yt”, i ka thënë, “sakaq këtu është adresa e milionerit. Edhe diçka. Duhet të më premtosh se nuk ke për ta lexuar këtë letër. Nëse e lexon, nuk do të kesh kurrfarë dobie prej saj... Por, në qoftë se, përkundër vërejtjes sime, megjithatë e hap, dhe, nëse edhe më tutje dëshiron të kesh dobi, duhet të bëhesh sikur kurrë nuk e ke hapur. Por, si të kthehet në gjendjen fillestare diçka që veçse ka ndodhur?!”

Djaloshi nuk ka pasur ide se për çfarë po fliste daja, por për këtë nuk ka menduar më. Dajën e tij gjithnjë e kanë marrë si eklektik. Po, më në fund, njeriu i ka bërë shërbim të mirë... ndaj, ka vendosur që për këtë të mos mendonte. I është falënderua dajës dhe ka shkuar.

## KREU 2

### Djaloshi e takon kopshtarin plak

Po atë pasdite djaloshi është nisur kah qyteza ku ka jetuar Instant Milioneri.

Si ka për t'u dukur takimi me të? Vallë, a do ta presë përzemërsisht mysafirin e paftuar dhe a do t'ia zbulojë sekretin e pasurimit?

Drejtperdrejt para se të arrinte para shtëpisë së milionerit, djaloshin e ka kapluar kërshtëria e papërmbajtur, ndaj, përkundër vërejtjes, e ka hapur letrën e rekomandimit të cilën daja ia shkroi me shumë dashuri. Por, i hutuar, e ka pyetur veten se mos, vallë, daja vetëm qenka mahitur me të – “rekomandimi” ka qenë vetëm një copë letër e zbrazët!

I dëshpëruar, ka menduar ta hidhte, por në atë çast e ka shikuar shtëpinë e Milionerit dhe para saj ka parë rojën; nuk ka patur dëshirë që ai ta shihte sesi po e hidhte letrën. Si të gjitha rojet, fytyra i kishte një shprehje guri, pa gjurmë të kurrfarë buzëqeshjeje. Në të vërtetë, është dukur njësoj i padepërtueshëm si edhe kështjella që ruante.

“Çfarë do të mund të bëja për ju?”, ka pyetur ai ftohtësisht.

“Dëshiroj ta takoj Instant Milionerin.”

“E keni të paralajmëruar takimin?”

“Jo, por...”

“Po mirë, keni atëherë farë rekomandimi?”, ka pyetur roja.

Natyrisht se ka pasur, por aty nuk ka shkruar gjë. Djaloshit shpejt i është kujtuar triku sesi të nxirrej nga situata. E ka nxjerrë letrën përgjysmë nga xhepi dhe përsëri e ka futur brenda. Kjo sakaq rojen nuk e ka kënaqur.

“A mund ta shoh letrën tuaj?”

Djaloshi është gjendur si i kapur në faj e sipër. Ka menduar: “Nëse ia jap letrën, do të mendojë se po e shpotis, por nëse nuk ia jap, nuk do të më lëshojë fare të hyj.”

Ishte i ballafaquar me një dilemë të madhe në dukje.

Por, në çast, i është kujtuar këshilla e dajës të cilën atëherë nuk e pati kuptuar: “Nëse e ke hapur letrën, duhet të shtiresh sikur atë nuk e ke bërë.”

A nuk ishte kjo e vetmja që i kishte mbetur? Ia dorëzoi letrën rojës, i cili, si të thuash, “e lexoi”! Fytyra i mbeti plotësisht pa shprehje.

“Në rregull”, tha dhe ia dorëzoi letrën djaloshit. “Mund të hyni.”

Roja pastaj e solli deri te porta e shtëpisë luksoze të Milionerit. Dyert i hapi shërbëtori i veshur pa asnjë të metë.

“Çfarë dëshironi?”, pyeti.

“Dua ta shoh Instant Milionerin.”

“I zënë është. Për momentin nuk mund t’ju pranojë. Ju lutem, ta pritni në kopsht.”

Shërbëtori e përcolli djaloshin deri te hyrja e kopshtit që më shumë i ngjante një parku. Në mes ishte pellgu i peshqve. Djaloshi u nis shtegut, duke u mahnitur

nga drunjtë e tejmrekullueshëm. Atëherë e pa kopshtarin i cili dukej si t’i kishte shtatëdhjetë vjet. Ishte i kërrusur mbi degzën e trëndafililit, të cilin e shkurtonte, kurse sheshiri prej kashte me rreth të gjerë ia mbulonte sytë. Kur djaloshi iu afrua, e ndërpreu punën dhe e përshëndeti. Qeshi. Pati sy të kthjellët, të hareshëm e të kaltër të cilët nuk ia jepnin ato vite.

“Çfarë ju ka sjellur këtej?”, e pyeti me zë të ngrohtë e miqësor.

“Kam ardhur ta njoh Instant Milionerin.”

“Aha, m’fal që pyes, po për çfarë?”

“Po, thjesht, që të më këshillojë.”

“Qartë...”

Kopshtari deshi që përsëri t’u përkushtohej trëndafilave të tij, por u drodh dhe e pyeti djaloshin: “Mos i ke rastësisht pesë funta?”

“Pesë funta?”, përsëriti djaloshi duke u skuqur. “Pikërisht aq kam... këto janë krejt sa kam, pesë funta.”

“Mrekulli. Pikërisht aq më duhen.”

Edhe pse dukej si lypsar, kopshtari megjithatë ishte dinjitoz. Qëndrimi i tij i jepte elegancë dhe sharm të veçantë.

“Me të vërtetë do t’jua kisha dhënë paratë”, u përgjigj djaloshi, “por, problemi është se nuk kam për t’u kthyer në shtëpi.”

“Planifikon të kthehesh sot?”

“Jo – në të vërtetë, nuk di”, u përgjigj djaloshi, duke qenë i hutuar. “Nuk do të kisha dëshiruar të kthehesha derisa nuk flas me Instant Milionerin.”

“Po nëse sot nuk të duhen ato të holla, pse po heziton të m’i japësh? Ndoshta nesër nuk kanë për t’u nevojitur më dhe, kushedi... ndoshta bëhesh milioner!”

Të menduarit e tillë djaloshit nuk i kumboi si diçka logjike, por i mungonte fuqia për debat të mëtutjeshëm. Prandaj, pas përsëritjes së kërkesës, ia dha paratë. Në fytyrën e kopshtarit u shfaq një buzëqeshje.

“Shumica e njerëzve frikësohen të pyesin për shërbimin, e kur atë përfundimisht e bëjnë, nuk janë mjaft rezistentë. Kjo është gabim.”

Në atë çast erdhi shërbëtori dhe iu drejtua zotërisë plak me shumë respekt: “Zotëri, a mund të m’i jepni pesë funta? Kuzhinieri sot po shkon dhe duhet paguar. Më mungojnë vetëm pesë funta.”

Kopshtari u qesh. Nxori nga xhepi dengun e trashë të parave. I ka pasur me siguri disa mijëra funta dhe atë në banknotat nga 25 dhe 50. Kopshtari e nxori monedhën prej pesë funtash të cilën djaloshi aq pa vullnet ia dha, ia afroi shërbëtorit i cili iu falënderua dhe duke u përkulur me dëgjueshmëri u largua kah shtëpia.

Djaloshi u tërbua. Si mundi kopshtari t’ia merrte aq paturpshëm 5 funtat e fundit që i kishin mbetur, kur xhepat i kishte plot para!



“Po pse m’i kërkuat 5 funtat?”, ka belbëzuar djaloshi, duke u munduar ta fshihte tërbimin që e kishte kapluar. “Nuk paskeni pasur nevojë!”

“Natyrisht se m’u kanë nevojitur. Shiko, nuk kam asnjë monedhë prej 5 funtash”, ka arsyetuar plaku, duke kaluar me gisht mbi dengun e trashë të parave. “Mos po mendon ndoshta se do t’ia jipja monedhën prej 50 funtash?”

“Po pse, vallë, mbani me vete aq shumë para?”

“Këto janë para xhepi, për shpenzime të vogëla”, u përgjigj kopshtari. “Gjithmonë kam ngat vetes dhjetë mijë funta, për çdo eventualitet.”

“Dhjetë mijë funta!”, pëshpëriti djaloshi i habitur.

Në çast, çdo gjë u bë e qartë – shërbëtor jashtëzakonisht dinjitoz, para xhepi jashtëzakonisht të shumta!

“Ju jeni Instant Milioneri, apo jo?”

“Tash për tash”, u përgjigj kopshtari, “më vjen mirë që na ke ardhur. Por, më thuaj kush të ka dërguar?”

“Daja im ka thënë se ai ka qenë i pari të cilit ia keni treguar sekretin.”

“Po, më kujtohet. Më ka vizituar para shumë vitesh. Ka qenë mendimtar tepër origjinal – thjesht, si edhe të gjithë njerëzit që vetë kanë përparuar. Por, më thuaj si ka ndodhur që nuk je i pasur? A ia ke shtruar, vallë, vetvetes ndonjëherë seriozisht këtë pyetje?”

“Dorën në zemër, jo.”

“Kjo ndoshta është gjëja e parë të cilën ka qenë dashur ta bësh. Nëse do, mund të mendosh me zë këtu para meje. Do të përpiqem ta përcjell mënyrën tënde të të menduarit.”

Djaloshi disa herë provoi, por pa sukses, dhe më në fund hoqi dorë.

“Po e shoh”, tha Milioneri, “nuk je mësuar të mendosh me zë. A e di, vallë, se ekzistojnë shumë njerëz në vitet e tua të cilët veçse janë pasuruar? Disa sosh madje janë milionerë. Të tjerët janë në pragun e tubimit të milionit të tyre të parë. A di ti se Aristotel Onazisi që në moshën njëzet e gjashtë vjeçare ka pasur në bankë 350 mijë funta, kur nga Amerika Jugore ka shkuar në Angli, ku ka dëshiruar ta themelojë mbretërinë me anije për të cilën ka ëndërruar?”

“Vetëm njëzet e gjashtë?”, ka pyetur djaloshi.

“Pikërisht aq. Kur ka filluar, i ka pasur gjithsej 250 funta. Nuk ka pasur as diplomë universiteti, as përvojë – e sigurisht nuk ka pasur kurrfarë njohësish e lidhjesh. Por tash është koha e drekës”, ka vënë re plaku. “A do t’me bësh shoqëri?”

“Faleminderit, shumë me kënaqësi.”

Djaloshi e ka pasuar Instant Milionerin i cili, përkundër viteve të veta, ende ka pasur ecje të shpejtë. Kanë hyrë në sallën ushqimore, ku tavolina veçse ka qenë e shtruar për dy vetë.

“Urdhëro, ulu”, i është drejtuar Instant Milioneri.

Me dorë ka treguar kryet e vendit, ulësen rëndom të rezervuar për zotin e shtëpisë. Vetë është ulur djathtas nga mysafiri i tij i ri, mu përballë orës së tejmrekullueshme prej rëre, ku ishte gdhendur motoja: KOHA ËSHTË ARË. Shërbëtori arriti me shishen e verës dhe ua mbushi gotat.

“Për milionin tënd të parë”, tha Milioneri duke ngritur gotën. E ka pirë gllënkën, e vetmja për tërë atë mbrëmje. Po ashtu ka ngrënë tejet pak – vetëm disa pjesë trofte jashtëzakonisht të shijshme.

“A e do punën tënde?”, e ka pyetur Milioneri djaloshin.

“Mendoj se e po.”

“Duhet të jesh i sigurt për këtë. Të gjithë milionerët të cilët i kam njohur – e kam njohur shumë gjatë gjithë këtyre viteve – e kanë dashur punën e vet. Për ta puna gati ka qenë argëtim, tërheqës si edhe çdo hobi. Pikërisht për këtë, shumica e të pasurve rrallë shkon në pushim. Pse të largohen prej asaj që aq shumë e donë? Kjo thjesht do të ishte një vetëdënim. Dhe pikërisht për këtë ata vazhdojnë të punojnë edhe pasi të bëhen milionerë të disafishtë. Megjithatë, edhe nëse pa kushtëzim kënaqesh në punën tënde, kjo megjithatë nuk është mjaft. Për t’u bërë i pasur, duhet ta dish të fshehtë. Më thuaj, a beson fare se ekziston fshehtësia?”

“Po, besoj.”

“Mirë. Ky është hapi i parë. Shumica e njerëzve këtë nuk e besojnë. Përpos kësaj, nuk besojnë madje as se mund të bëhen të pasur. Dhe kanë të drejtë. Secili që nuk

beson se mund të bëhet i pasur, rrallë bëhet. Duhet të fillosh të besosh që të mund të dëshirosh me pasion. Por, kisha për të shtuar se shumë njerëz, do të thoja shumica, po ashtu nuk janë të gatshëm ta pranojnë fshehtësinë, madje edhe kur t’iu zbulohet dhe t’iu përshkruhet në mënyrë fare të thjeshtë. Në të vërtetë, problemi i tyre më i madh është mungesa e imagjinatës. Kjo ndoshta është shkaku themelor pse sekreti i pasurimit është sekret i ruajtur në botë.”

“Kjo është si letra e vjedhur nga tregimi i Edgar Allan Poe-së”, vazhdoi Instant Milioneri. “A e di atë tregim? Flet për letrën të cilën policia e ka kërkuar në shtëpinë e dikujt dhe kurrë s’e ka gjetur, sepse ka qenë në vendim më së paku të besueshëm – gjithnjë para syve! Tregimi është ilustrim i këndshëm i njërit prej parimeve të Emersonit. Ajo që e ka penguar policinë ta gjejë letrën, ka qenë mungesa e imagjinatës, apo thënë ndryshe, pasojë e paragjykitimit. Nuk kanë besuar se aty mund ta gjejnë – prandaj nuk kanë pasur sukses.”

Djaloshi me kujdes e ka dëgjuar Milionerin. Askush deri më tash nuk i është drejtuar në këtë mënyrë dhe kërkuesia i është rritur. E ka djegur dëshira të dijë se ku është sekret. Gjithsesi, një ka qenë e sigurt: edhe po qe se Milioneri nuk do të kishte sekret, me siguri ka qenë skenarist i shkathtë. Mbi të gjitha, ka ditur si t’i shpjegojë gjërat – thjesht dhe qartë, pos nëse kjo nuk ka qenë mashtrim i menduar shkathtësisht.

## KREU 3

### **Djaloshi mëson sesi shfrytëzohen rastet dhe si i hyhet rrezikut**

“Tash, pas gjithë kësaj që ke dëgjuar, a dëshiron të ta zbuloj të fshehtën e pasurimit?”

Pyetja e Milionerit e ka befasuar djaloshin.

“Edhe po të doja ta paguaja atë sekret, nuk kam para dhe për këtë më vjen vështirë të përgjigjem në këtë pyetje.”

“Por, po të kishe para, sa do të kishe paguar?”  
Pastaj Milioneri ka shtuar: “Thuaje shumë, sadoqoftë. E para që të bie ndër mend.”

Djaloshi më kurrsesi nuk ka mundur t'i ikën përgjigjes. Milioneri ka kërkuar përgjigje krejtësisht të përcaktuar dhe ai nuk ka mundur të bëhet i shurdhët para pyetjes së nikoqirit të tij.

“Nuk di. Ndoshta 100 funta...”

Milionerit i ka shpërthyer gazi. Djaloshi për të parën herë e ka dëgjuar sesi qeshte me zë.

“Vetëm 100?! Domethënë, ti në të vërtetë nuk besuake se fshehtësia ekziston! Po të besojë, sigurisht do të ishte i gatshëm të paguajë shumë më tepër. Jo – provo përsëri. Thuaje një shumë tjetër – kjo nuk është lojë, por diçka shumë serioze.”

Djaloshi është menduar. Do të kishte dhënë çdo gjë në botë që Milioneri të mos e përqueshte. Por njësoj nuk dëshironte të thoshte shumë e cila do ta komprometonte.

“Nuk kam asgjë kundër lojës suaj të vogël”, ka thënë, “por mbajeni në mend – unë jam pa asnjë dysh në xhep!”

“Mos u brengos për atë.”

“Por, pa të holla duart i kam të lidhura”, i është kundërvënë djaloshi paksa i hutuar.

“Ah!” ka psherëtitur Milioneri, “rrugë e gjatë është para nesh. Që kur ekziston bota dhe jeta, të pasurit kanë shfrytëzuar paratë e huaja për të grumbulluar pasurinë e vet. Asnjërit, sadopak serioz, nuk i duhet për të fituar para. Mendoj në paratë e gatshme të miat. Pos kësaj, sigurisht e ke librezën e çeqeve me vete.”

Djaloshi do të dëshironte që të mund ta kontestonte, por mu atë mëngjes i kishte vënë çequet në xhep; Zoti e di pse, duke patur parasysh se në to kishte vetëm 12,28 funta nga xhirollogaria e tij – gjithsesi e pamjaftueshme për ndonjë argëtim më të madh. Në ndonjë rast tjetër djaloshi nuk do të kishte menduar shumë, do të kishte gënjyer, por jo edhe tash kur Milioneri ashtu depërtueshmërisht e ka vështruar, sigurisht i aftë të kridhej gjer tek mendimet e tij më të fshehta. Gati si ta pranonte ndonjë të fshehtë të thellë të errët, djaloshi e ka dëgjuar veten sesi mërmëriste:

“Po, e kam marrë me vete.”

Atë çast djaloshi e ka kuptuar sesi automatikisht e nxirrte librezën e çeqeve ngjashëm me robotin i cili i

dëgjon urdhrat e zotërisë së vet, edhe pse njëkohësisht kokën ia ka përshkuar mendimi që të rebelohej. Është ndier sikur ai njeri ta kishte magjepsur, si ta kishte hipnotizuar. Nuk i është frikësuar Milionerit i cili ka rrezatuar shpirtmirësi – edhe pse me dozë të lehtë ironie.

“Në rregull”, është përgjigjur Milioneri, “tash e sheh se nuk ka problem.”

Me lëvizje elegante e ka hapur stilolapsin dhe ia ka ofruar djaloshit.

“Shkruaje shumën që e ke ndër mend dhe nënshkruaje çekun.”

“Por nuk di sa të shkruaj.”

“Në rregull. Shëno, ta zëmë... 10.000 funta.”

Milioneri atë shumë e ka thënë krejt lehtë, pa fije kryelartësie. Djaloshi pothuajse ka dalur nga lëkura. Një ishte e vërtetë: Milioneri po e tallte... pos nëse nuk ka qenë ndonjë mashtrimtar!

“Dhjetë mijë funta!”, ka ngritur zërin djaloshi. “Sigurisht po talleni.”

“Shënoji 20.000 funta, nëse dëshiron”, është përgjigjur Milioneri ashtu qetësisht saqë djaloshi më nuk ka qenë i sigurt nëse fliste seriozisht apo tallej.

“Edhe 10.000 më duken tepër. Gjithsesi, nuk do të mund ta paguaj çekun, sepse do të jetë pa mbulesë. Dhe krejt ajo që unë prej kësaj do të fitoj është bankieri i hidhëruar i cili do të mendojë se jam çmendur – dhe do të ketë të drejtë!”

“Pikërisht kështu e kam kryer edhe unë punën time më të madhe. E kam nënshkruar çekun prej 10.000 funtash, e pastaj ka qenë dashur me panik të kërkoja vërdallë të holla për të pasur mbulesë. Por, sikur në atë vend dhe në atë çast të mos e kisha nënshkruar atë çek, do ta kisha huqur rastin e jashtëzakonshëm.”

“Kjo ka qenë një nga lekcionet e para afariste”, ka vazhduar. “Njerëzit që humbin kohën dhe i presin rastet ideale, kurrë nuk bëjnë kurrgjë, koha ideale për aksion është – T A S H! Dhe kjo anekdota e vogël mund të ta mësoj lekcionin e dytë: nëse dëshiron të kesh sukses në jetë, duhet të jesh i bindur se nuk ke zgjedhje tjetër. Duhet ta sjellësh veten para aktit të kryer. Njerëzit të cilët lëkundën dhe nuk dëshirojnë t’i hyjnë rrezikut, nën justifikimin se ende nuk janë krijuar kushtet, nuk mund të kenë sukses. Arsyeja është e thjeshtë. Kur të mbyllën të gjitha shtigjet e mundshme dhe gjendesh para murit, atëherë i mobilizon të gjitha forcat e tua. Në atë çast me tërë qenien tënde dëshiron që diçka të ndodhë.

Pse tash po lëkundesh, djalosh? Ndalë para murit. Nënshkruaje atë çek prej 10.000 funtash!”

Djaloshi e plotësoi çekun, së pari ngadalë duke shënuar shumën me numra, e pastaj me fjalë. Ndërkaq kur duhej ta nënshkruante, nuk kishte forcë.

“Kurrë në jetën time nuk kam nënshkruar çek me shumë kaq të madhe.”



“Nëse dëshiron të jesh milioner, duhet t’ia fillosh një ditë. Duhet të mësosh t’i nënskruash çeqet me shuma edhe më të mëdha se kjo. Ky është vetëm fillimi.”

E megjithatë, djaloshi ende nuk kishte forcë ta nënshkruante çekun. Çdo gjë ndodhte aq shpejt. Duhej t’i jepej çeku prej 10.000 funtash njeriut të cilin sa e kishte takuar e i cili si këmbim po i ofronte një fshehtësi mjaft të dyshimtë.

“Çfarë po të pengon ta nënshkruash çekun”, ka pyetur Milioneri. “Çdo gjë në botë është relative. Për një kohë tepër të shkurtër kjo shumë ka për t’u dukur e parëndësishme.”

“Nuk është çështja te shuma”, ka mërmëritur djaloshi, memzi duke e ditur se çfarë po fliste.

“Po, ku është çështja atëherë?”

Pikërisht përgatitej të fliste, kur Milioneri e ndërpreu: “E di pse nuk po mund ta nënshkruash. Ti, në të vërtetë, nuk beson se fshehtësia ime do të të bëjë milioner. Po të ishte absolutisht i sigurt, do ta kishte nënshkruar në sekondë.”

Për ta bindur apo që, në të vërtetë, më qartë ta ilustronte pikëpamjen e vet, Milioneri ka shtuar: “Po të ishte vërtet i sigurt se fshehtësia ime ka për të ndihmuar t’i fitosh 50.000 funta për më pak se një vit dhe atë në atë mënyrë që të mos punosh më tepër sesa tash punon – madje, të punosh edhe më pak – a do ta nënshkruaje çekun?”

“Sigurisht se po”, ishte shtrënguar të pranonte. “Do t’i kisha patur 40.000 funta fitim.”

“Po atëherë nënshkruaje! Unë formalisht të garantoj se ti mund ta fitosh atë shumë.”

“A do të ma vërtetonit këtë me shkrim?”

Përsëri Milionerit i ka shpërthyer gazi.

“Po m’pëlqen, djalosh. Ke vendosur ta mbrosh shpinën. Kjo shpesh është urti e madhe. Madje edhe po të jesh plotësisht i sigurt në mundësitë e tua financiare, kjo nuk do të thotë se duhet t’i besosh personit të parë që takon.”

Pastaj është ngritur, ka hallakatur pak në syzën e tavolinës dhe e ka nxjerrë formularin e gatshëm të cilin do ta ketë përdorur në situata të ngjashme. Kjo nuk i pëlqeu gjithaq djaloshit. Mos, vallë, kjo tregonte se plaku shpesh e ka zbuluar fshehtësinë dhe ia ka shitur cilitdo njeri që ka ardhur?

Milioneri e ka mbushur formularin dhe ia ka ofruar djaloshit i cili e ka lexuar shumë shpejt duke mos e fshehur kënaqësinë për atë që sapo lexoi. Atëherë plaku papritmas e ka ndërruar mendimin.

“Kam një ide tjetër”, ka thënë. “Si do të ishte ta bënim me short?”

E ka nxjerrë paranë nga xhepi dhe e ka vënë mbi shuplakë.

“Hajde të provojmë: kokën – letrën. Nëse humbas, t’i jap 10.000 funta para të gatshme të cilat i kam në xhep. Nëse fitoj, ke për të ma dhënë çekun. Ta harrojmë garancinë.”

Djaloshit iu desh një minutë të mendonte për këtë propozim shumë të pazakonshëm. Nuk ishte ide e keqe. Në të vërtetë ishte aq joshëse saqë e ka pyetur veten se përse ky djall plak po e propozonte si mundësi të parë. Ishte më tepër se mirë për të qenë e ndershme.

“Problemi i vetëm, siç ju kam thënë, është ai se kam pak para në bankë. Madje edhe sikur t’jua jap çekun nuk do të vlente.”

“S’ka problem”, ka thënë Milioneri, “nuk më ngutet dot. Do të pres deri në takimin tonë të ri. Pse të mos ia vëmë datën – një vit prej sotit?”

“Në rregull. Me këso kushtesh po e pranoj shortin.”

Mendoj se dosido e ka një vit të tërë për ta ndërruar bankën, për ta mbyllë xhirollogarinë dhe thjesht për t’ia mohuar fjalët atij njeriu. Ka mundur edhe më herët t’i kujtohej kjo. Nuk ka pasur se çfarë të humbasë. Kurse me oferten e re të Milionerit ka mundur lehtësisht t’i fitojë madje 10.000 funta për disa sekonda, bile duke mos luajtur as nga vendi.

Dhe, edhe përkundër vullnetit të vet, buzëqeshja e vetëkënaqësisë ia ka rrezatuar fytyrën. Me ndjesi faji ka shpresuar se Milioneri këtë nuk do ta vinte re, edhe pse e kishte të qartë se plaku ishte tepër mendjehollë. Nuk ishte i sigurt. Në këtë çast, Milioneri ka dhënë sqarim të shkurtër i cili menjëherë i ka vërtetuar dyshimet e djaloshit.

“Vetëm edhe diçka. Në rast se e humb shortin, dëshiroj që të betohesh ndershmërisht se do ta paguash çekun.”

Djaloshi është skuqur. Plaku është më dinak se dhelpëra, ka menduar. I është dukur se po e lexonte si librin e hapur. Djaloshi i ka dhënë fjalën e nderit dhe kur Milioneri është përgatitur ta hidhte monedhën, ai befasisht e ka ndalur.

“A mund ta shoh monedhën?”, ka pyetur.

Milioneri ka qeshur. “Natyrisht. Vërtet po më pëlqen, djalosh. I vëmendshëm je. Kjo ka për t’ndihmuar që t’iu ikësh shumë gabimeve. Por shiko që kjo të të mos pengojë e t’i humbasish shumë raste të mira.”

Milioneri atëherë ia ka zgjatur monedhën me dashuri. Pasi që djaloshi i ka shikuar me vëmendje të dy anët, ai e pyeti se çfarë po zgjidhte.

“Letrën” është përgjigjur.

Milioneri e ka hedhur monedhën lart. Zemra e djaloshit ka rrahur fuqishëm si në takimin e parë të dashurisë. Ka qenë për të parën herë pranë mundësisë për t’i fituar 10.000 funta, e kjo nuk ishte punë e vogël. Derisa ka vështruar sesi monedha rrotullohej në ajër, trazimi i tij është rritur gjithnjë e më tepër. Monedha është rrotulluar mbi tavolinë dhe përfundimisht është qetur.

“Koka!”, ka konstatuar Milioneri hareshëm, por menjëherë me keqardhje ka shtuar:

“Më vjen keq.”

Ishte vështirë të thuash në ishte i sinqertë apo vetëm i dashur.

Djaloshi vendosi ta nënshkruante çekun. E megjithatë, nuk ka mundur e që të mos psherëtitë. Sigurisht

se një ditë do të mësohet të nënshkruajë çeqe si ky, por në këtë moment kjo i është dukur vërtet shumë e çuditshme. Ia dorëzoi çekun Milionerit, ai e shikoi me shpejtësi, e paloi dhe e futi në xhep.

“E tash”, i tha djaloshi, “a mund të ma zbuloni të fshehtën?”

“Natyrisht”, u përgjigj Milioneri. “A ke një copë letër? Të ta shkruaj. Ashtu nuk do ta harrosh.”

Djaloshi e kishte të vështirë t’i kuptonte ato fjalë. Milioneri sigurisht nuk ka menduar seriozisht që tërë fshehtësinë ta përshkruajë në një copë të vetme letre – e sidomos jo të fshehtën të cilën ai e pagoi 10.000 funta.

“Më fal, por nuk kam letër me vete.”

Dhe përsëri e kaploi trazimi kur Milioneri e pyeti:

“Nuk e ke vallë letrën rekomande të cilën e solle me vete? Njerëzit që m’i ka dërguar daja yt gjithmonë e kanë pasur atë letër.”

Djaloshi akoma e kishte letrën. E ka nxjerrë nga xhepi, duke menduar se mos vallë plaku e ka harruar trikun. Ia ka ofruar dhe vëmendshëm e ka soditur fytyrën e plakut gjersa e hapte letrën. Nuk dukej se Milioneri ishte i befasuar që letra ishte plotësisht e zbrazët. E ka nxjerrë lapsin, është kërrusur mbi tavolinë dhe mu kur dukej se diçka do të shkruante, e ka ngritur kokën dhe e ka lutur djaloshin që të shkonte e ta thërriste shërbëtorin.

“Do ta gjesh në kuzhinë krejt në fund të këtij korridor”, ka sqaruar Milioneri.

Kur është kthyer me shërbëtorin, Milioneri e kishte mbyllur kovertën. Ka qeshur dhe është dukur i kënaqur me vetveten.

“Mysafiri ynë i ri do të flejë te ne”, i tha shërbëtorit. “A dëshironi, ju lutem, që ta dërgoni gjer tek dhoma e tij?”

Sakaq, duke iu kthyer djaloshit, tha: “Këtu është e fshehta.” Është ngritur, ia ka ofruar kovertën disi solemnisht si ta bënte pikërisht njëren nga punët më të rëndësishme në jetë.

“E vetmja gjë që dëshiroj të të lus është që të presësh për ta lexuar gjersa nuk je vetë në dhomën tënde. Atëherë hape letrën dhe lexoje fshehtësinë. Po, ekziston edhe një kusht. Para se ta lexosh atë që e kam shkruar, betomu se pjesën e jetës tënde ke për t’ia kushtuar asaj që këtë fshehtësi ta ndash me ata që nuk janë të lumtur si ti. Nëse pajtohesh, do të jesh personi i fundit të cilit personalisht do t’ia zbuloj këtë sekret. Puna ime do të jetë e kryer. Atëherë do të mund t’iu përkushtohem luleve në një kopsht shumë më të madh. Nëse nuk ndihesh i gatshëm që këtë sekret ta ndash”, ka konstatuar, “akoma ke kohë që të tërhiqesh. Por atëherë, natyrisht, nuk do të mund ta hapësh letrën. Ta kthej çekun. Mund të kthehesh në shtëpi e ta vazhdosh jetën e njëjtë si edhe gjer tani.”

Tash kur djaloshi e kishte përfundimisht letrën me sekretin e famshëm në të, nuk kishte gjasa që të tërhiqej. Kureshtja ishte fuqizuar.

“Betohem”, u përgjigj.

## KREU 4

### Djaloshi ndihet i robëruar

Së frikti u gjet i vetëm në dhomën e tij e cila ishte e mobiluar në mënyrë aq luksoze saqë ishte i shtrënguar ta shikonte mirë që nga dyshemeja e gjer në plafon. Është dukur sikur e ka harruar letrën e çmueshme të cilën aq shtrenjt e ka paguar. Ka shkuar deri tek dritarja e vetme në dhomë e cila ka qenë lart mbi tokë dhe ka shikuar kah kopshti. Ka mundur madje të shohë dhe atë pjesë kopshti ku për herë të parë e ka takuar Milionerin sesi i punonte trëndafilat e tij me plot kujdes e dashuri.

Ka rënë nata dhe hëna e plotë gjithkund ka derdhur shkëlqim vezullues. Djaloshi tashmë është bërë skajshmërisht i padurimshëm. Përfundimisht do ta mësojë të fshehtën sesi të pasurohet, atë fshehtësi e cila për aq shumë vite i është dukur e paarritshme.

E ka hapur kovertën, e ka shpalosur letrën dhe ka zënë me kujdes ta kontrollojë. Copa e letrës para tij ka qenë plotësisht e zbrazët! E ka kthyer në anën tjetër. Askund nuk ka pasur as më të voglën vizë. Ka qenë mjaft budalla për të lejuar që plaku ta mashtrojë. E ka dhënë çekun me shumën kolosale në këmbim të fshehtësisë që nuk ekziston.

E megjithatë, Milioneri, në të vërtetë, i është dukur simpatik dhe i ndershëm, madje ka filluar edhe t'i pëlqejë. Djaloshi e ka kuptuar se ka qenë dashur të ishte pak më i

vëmendshëm, sepse ka diçka të vërtetë në atë thënien se njerëzit krejtësisht të ndershëm nuk mund të pasurohen.

Ka qenë i detyruar ta pranojë se nuk ka shpirt afarist – sigurisht për këtë edhe është ngulur në trikun e plakut.

E ka përshkuar dëshira për rebelim dhe, në tërbim e sipër, e ka shqyer letrën përgjysmë dhe e ka hedhur mbi tepihun e trashë të kadifenjtë. Të vetmin ngushëllim e gjente në të vërtetën se budallallëku nuk e ka mbytur askë.

Çfarë mund të bëjë tash? Ka pasur diçka joreale në tërë këtë tregim. Ka lejuar ta mashtrojnë në kurthin mirë të përgatitur. I ka mbetur vetëm të çlirohet sa më parë që të jetë e mundur. Kushedi? Ndoshta edhe jetën e ka në rrezik. Duhet shpejt të vendosë. Nuk dëshiron që natën ta kalojë në këtë vend.

Më së miri do të ishte që të përvidhej sa më pahetueshëm që të jetë e mundur. Ka ardhur në majë të gishtërinjve gjer te dera dhe ngadalë e ka lëvizur rezën. Në djall të mallkuar! Dyert kanë qenë të mbyllura. Ndihet i robëruar. Dritarja ka qenë dalje alternative. Ka vrapuar drejt saj. E ka hapur lehtësisht, por ajo ka qenë 9 metra mbi tokë. Po të kërcente, sigurisht do ta thyente qafën. Më mirë të mendonte për mënyrën tjetër të ikjes. Shpresë e vetme i ka mbetur që ta ftonte shërbëtorin. Nuk i erdhi dot në shprehje që tinëzisht të përvidhej nëpër natë.

Ka cingëruar dhe pritur. Askush nuk ka ardhur. Ka cingëruar përsëri. Asgjë!

Qetësia e plotë e ka mbushur shtëpinë. Duhet të kenë fjetur të gjithë. Ndoshta zilja është e prishur. Në atë



rast e vetmja që i ka mbetur ka qenë të bërtasë. Por këtë nuk ka mundur ta bëjë. E çfarë nëse Milioneri, përkundër të gjitha dyshimeve, ka qenë qëllimshëm? Do të dukej si budallai që i zgjon të gjithë në mes të natës.

Përfundimisht është përcaktuar për të fjetur. Por kjo nuk ka qenë e lehtë. Ngjarjet e asaj dite i janë rrotulluar para sysh. Përkundër argumenteve që ka provuar t'i gjejë, vështirë ka luftuar me ndjenjën e absurditetit e cila gjithnjë e më shumë e ka pushtuar. Copën e letrës së zbrazët, të cilën e kishte blerë 10.000 funta, e kishte gjithnjë para sysh, si ta qesëndiste. Për fat, gjumi e ka shpëtuar nga këto ankthe. Por, jo për kohë të gjatë. E ka ëndërruar të huajin i cili gjithnjë e shtynte ta nënshkruante dokumentin e gjerë, të një rëndësie të veçantë, sikur prej tij të varej jeta e tij. Është kundërvënë fuqishëm. Duhet të jetë ndonjë gabim, dokumenti ka qenë – letër e zbrazët!

## KREU 5

### Djaloshi mëson të besojë

Në mëngjes djaloshi është ndier sikur ta kishte shkelur kamioni prej tri tonelatash. Si ndonjë porosi, era që frynte nëpër dritaren e hapur lehtësisht e ka ngritur letrën e turpshme dhe si në mënyrë magjike përsëri e ka vënë te këmbët e krevatit të tij. Kjo ka qenë gjëja e parë mbi të cilën e ka hedhur shikimin atë mëngjes dhe e ka pushtuar tërbimi. Kishte fjetur i veshur dhe tash ishte tërësisht i zhubravitur, por kjo më së paku e ka brengosur. Ka menduar vetëm në një gjë: ta gjente plakun, t'ia kthente fshehtësinë dhe ta merrte çekun prapa. E ka hedhur shikimin mbi pasqyrë dhe ka konstatuar se dukej i tmerrshëm. Kjo vetëm sa e pasonte vendimin e tij.

Kaloi me gishtërinj mbi flokë disa herë. U nis kah dera dhe në të njëjtin moment iu kujtua se dera mbrëmë ishte e mbyllur e se ndoshta ende ishte e mbyllur. Por, nuk ka qenë. Ka daluar dhe me hapa të hidhëruar është drejtuar kah dhoma e ndejës.

E priste Instant Milioneri duke ndenjur qetësisht pranë tavolinës, i veshur njësoj si edhe një ditë më parë: petku i kopshtarit ishte i thjeshtë dhe i pastër, por shumë i vjetëruar. Sheshiri i tij me majë me rreth të gjerë i cili, po të mos ishte prej kashte, do të dukej si sheshir magjistari, rrinte para tij mbi tavolinë. Milioneri e ka hedhur monedhën dhe ka numëruar. Kishte ardhur gjer në 8.

“Nëntë” ka mërmëritur, duke mos e ngritur shikimin nga monedha. “Dhjetë”. Por, nuk ia doli të arrijë në dhjetë, ndaj shajti. E ka ngritur kokën, duke e përgatitur monedhën. “Kurrë nuk kam arritur më shumë se dhjetë”, ka konstatuar. “E fitoj ‘letrën’ dhjetë herë rresht, e pastaj gjithmonë ‘kokën’ në hedhjen e njëmbëdhjetë, edhe pse gjithnjë e hedh në të njëjtën mënyrë.”

Djaloshit në çast i ka kaluar nëpër kokë mendimi. E ka kuptuar se mbrëmë për herë të dytë ia kanë vënë samarin. Nuk ka pasur mënyrë ta fitojë shortin pa marrë parasysh në ka rënë ‘koka’ apo ‘letra’.

“Babai im, i cili ka qenë magjistar, gjithnjë ka arritu gjer në pesëmbëdhjetë”, ka sqaruar Milioneri, “por unë nuk e kam trashëguar atë talent.”

Djaloshi ka kërkuar ta shihte monedhën. Pasi që Milioneri hareshëm ia ka ofruar, e ka hedhur mbi tavolinë.

Koka. Letra. Koka. Letra. Pa dyshim nuk ka qenë çështja te monedha, përpos nëse ka qenë ndonjë trik që i ka shpëtuar vërejtjes së tij.

“Asgjë nuk ka pasur të pandershme në shortin tonë të djeshëm”, ka konstatuar Milioneri. “Thjesht e kam treguar shkathtësinë time në përdorimin e parasë. Përpos kësaj, nuk është hera e parë që njerëzit sjellin përfundime të atilla. Ata shpesh e zëvendësojnë aftësinë me pandershmërinë.”

Djaloshi nuk ka ditur ç’ të thoshte lidhur me këto. E pastaj i është kujtuar se përse kishte zbritur që ta takonte

plakun. E ka vringëlluar letrën në ajër dhe e ka hedhur mbi tavolinë.

“Bukur më keni mashtruar, zotëri. Lehtë i keni fituar 10.000 funta për një copë letër të zbrazët.”

“Nuk është e zbrazët. Kjo është e fshehta e pasurisë”, e ka përmirësuar Milioneri.

Djaloshi ka pritur nga Milioneri që së paku të kërkonte ndjesë.

“Por, do të duhej të ishit më të qartë. A po mendoni se jam idiot?”

“Idiot? Natyrisht se jo. Thjesht të mungon mendjemprehtësia. Kjo është krejt e zakonshme. Mendja jote akoma është e re dhe papjekur.”

“Ndoshta është, por gjithsesi mund ta njoh copën e letrës së zbrazët kur e shoh – dhe faktin se – sa çil e mbyll sytë – ‘ma keni lëshuar mjekrën’.”

“Nuk di çka dëshiron akoma. Të garantoj se vërtet mund të bëhesh i pasur vetëm me këtë fletë të zbrazët letre. Kjo është e tëra që m’u ka dashur për t’u bërë milioner atëbotë heret, kur... por, duke qenë se nuk kam shumë kohë, sepse duhet të kthehem dhe t’u përkushtohem trëndafilave të mi të dashur, do të të ndihmoj. Dëgjo me vëmendje, sepse posa të arrish ta vëresh atë fshehtësi duhet t’ua sqarosh të tjerëve. Njëherë kur të çlirohesh nga prangat e varfërisë, duhet t’ua tregosh atë rrugë atyre të cilët akoma i kanë të lidhura duar e këmbë. A mund të ju lus ta përsërisni betimin e djeshëm?”

Pa dyshim kurrë në jetë nuk ka takuar asnjëri të kishte forcë të tillë bindëse. Vetëm para disa çastesh djaloshi ka qenë i gatshëm ta mallkonte me tërë fuqinë, kurse tash veçsa nuk hante nga duart e plakut!

Madje as nuk i ka shkuar mendja të refuzonte ta përsëriste betimin e djeshëm. Përsëri solemnisht është betuar. Mbi fytyrën e Milionerit është endur qeshja, njësoj si edhe dje kur djaloshi sa e kishte njohur.

“Kam vendosur të ta zbuloj fshehtësinë, duke qenë se nuk ke mundur vetë ta zbulosh. Duhet përsëri të ta tërheqë vërejtjen se duket së tepërmi e thjeshtë për të qenë e vërtetë. Por mos lejo që thjeshtësia e saj të të mashtrrojë. Secilën herë kur dyshon, kujtoje Mocartin. Gjeniu i vërtetë jeton thjesht. Pasi që akoma je i ri, në fillim do të jesh i prirur për dyshime. Me kohë, ashtu siç pasuria do të ngjitet për ty në mënyrat më të pazakonshme, ke për t’ia filluar të kuptosh.”

“Do të jem i ndershëm ndaj jush”, ka thënë djaloshi. “Vërtet me krejt zemrën time shpresoj se kam për ta kuptuar!”

“Aq më mirë. Vetëm kur diçka kupton, mund t’i besosh. Njëherë kur ta njohësh të fshehtën, e di se për ç’arsye beson në të. Por, në fillim, përkundër thjeshtësisë së saj, ajo fshehtësi do të jetë aq befalusuese sa që nuk do të mund ta kuptosh – e as të besosh në të. Prandaj të lus që pak të mundohesh dhe të besosh. Kjo është ngapak si kur skeptiku i drejtohet Zotit. Nëse Zoti ekziston, ka për t’i fituar të gjitha shkakun i besimit të vet. Nëse nuk ekziston,

asgjë nuk ka për të humbur. E njëjta mund të vlejë edhe për këtë fshetësi.

## KREU 6

### Djaloshi mëson sesi të përqendrohet në qëllimin

“Lirisht më pyet çfarë të bie ndër mend”, ka thënë Milioneri. “Do ta kem kënaqësinë të të përgjigjem. Së frikti nuk do të kesh rast dhe, pasi që koha të cilën do ta kalojmë së bashku është e kufizuar, eja e të mos e shfrytëzojmë për debate të padobishme. Qe lapsin. A ke një copë letër?”

“Qe.”

“A dëshiron vërtet që të jesh i pasur?”

“Natyrisht se po.”

“Atëherë, në rregull. Shkruaje shumën e të hollave që e dëshiron dhe sa kohë të duhet për ta realizuar. Kjo është fshehtësia misterioze e pasurimit.”

Djaloshi mendoi se Instant Milioneri përsëri po ia vinte samarin.

“A po mendoni se paratë do të bien ashtu nga qielli vetëm për atë se i kam shkruar disa numra në letër?”

“Po, mendoj”, ishte e tëra që Milioneri e pa të nevojshme të thoshte. “Reagimi yt aspak nuk më befason. Ta kam tërhequr vërejtjen se fshehtësia do të jetë e thjeshtë, por ti megjithatë akoma je i hutuar. Më lejo të të them edhe diçka para se të hyj në sqarime. Të gjithë milionerët që kam takuar ma kanë pranuar se janë bërë të pasur në atë çast kur

e kanë përcaktuar shumën dhe afatin deri kur dëshirojnë ta realizojnë atë shumë.”

“Më vjen keq, por akoma nuk po kuptoj. Çfarë dobie prej asaj se do ta shkruaj shumën dhe afatin?”

“Nëse nuk di kah shkon, gjasat janë të mëdha që askund të mos arrish.”

“Ndoshta, por kjo po më ngjan me magjinë.”

“Pikërisht këtu është çështja – fshehtësia magjike e qëllimit kuantitativ të përcaktuar. Ta shikojmë tash këtë problem nga këndi tjetër. Ta zëmë se dëshiron të zësh punë. I bën të gjithë hapat e nevojshëm dhe përfundimisht shkon në bisedime dypalëshe. Pas një kohe të shkurtër e merr përgjigjen se ke hyrë në zgjedhjen e ngushtë. Pastaj e konstaton se ke hyrë në punë dhe se do të kesh fitim të madh. Si ke për të reaguar? Në fillim do të jesh i kënaqur vërtet me vetveten. Të jesh i zgjedhur në mesin e dhjetëra, e ndoshta edhe qindëra kandidatëve – çfarë suksesi! Dhe duke pasur parasysh se punë vështirë mund të gjesh, apo ndoshta je i papunësuar qe tre muaj, apo ndoshta ke pasur punë por je ngopur me të që para një viti, mendon se kjo vërtet është një arritje e mirë. Por, pasi të kalojë euforia fillestare, cili do të ishte reagimi yt i parë?”

“Po, do të kisha pyetur se kur do t’ia filloja punës. Atëherë do të kisha dëshiruar të di se çfarë në të vërtetë do të thotë ‘fitim i mirë’. Meqë të gjitha gjërat në këtë botë janë relative, do të provoja ta mësoja se sa – saktësisht – e kam fitimin dhe çfarë beneficimesh do të kem.”



“Pikërisht ma ke marrë fjalën nga goja. Nëse, për shembull, e pyet shefin tënd të ri se çfarë ka nënkuptuar me ‘fitim të mirë’, e ai vetëm të thotë se garanton se gjithsesi ke për të fituar shumë, nuk ke për t’u ndier mirë, apo jo? Edhe më keq, ke për të filluar të dyshosh në ndershmerinë e tij, sepse fakti se po refuzon të ta thotë shumën e përcaktuar gjithsesi e nënkupton se ekziston diçka e dyshimtë apo se fitimi nuk do të jetë aq i madh siç paraqitet. Po ashtu, nëse refuzon të ta tregojë ditën e saktë se kur duhet të fillosh në punë, nuk do të jesh shumë i lumtur, apo jo? Do të provosh ta detyrosh të deklarohet.”

“Sigurisht këtë do ta bëja”, është pajtuar djaloshi, duke mos gjetur gabim në argumentet e qarta të plakut.

“Dhe nëse përkundër insistimit tënd nuk mund t’i mësosh detajet e dëshirueshme, ndoshta më me kënaqësi do ta refuzojë ofertën dhe do të kërkojë punë në tjetër vend. Në të vërtetë, do të kishe plotësisht të drejtë ta bëje këtë.”

“Keni të drejtë. Ai shef ose tallet me mua ose është mashtrimtar i vërtetë. Duhet ta pranoj se në të dyja rastet oferta e tillë është e pashprehur saktë.”

Milioneri është dukur i kënaqur siç sigurisht ka qenë i kënaqur edhe Sokrati pas debatit jashtëzakonisht të vështirë me nxënësit e vet. Për një çast është ndalur e pastaj ka vazhduar me çëshjen paksa ironike, por megjithatë buruar nga një shpirt i mirë:

“Pyetjet që pikërisht ia parashtrove punëdhënësit të paramenduar, i ke parashtruar për të ditur gjëra me rëndësi, apo jo? Vetëm deklarimi se do të kesh fitim të mirë nuk

është mjaft. Ke dëshiruar, po ashtu, të dish sa. Nuk të ka kënaqur vetëm fakti se ke gjetur punë. Ke dëshiruar, përpos kësaj, të dish se kur do t'ia fillosh saktësisht të punosh. Sigurisht krejt këto do t'i kërkoje me shkrim, pasi që marrëveshja me shkrim ka peshë më të rëndë nga marrëveshja me gojë. Natyrisht, fjala do të duhej të ishte mjaft. Por, fjalët janë kalimtare, kurse fjalët e shkruara janë të qëndrueshme. E njëjta mund të zbatohet edhe në jetë. Ajo për të cilën shumica e njerëzve nuk janë të vetëdijshëm, e sidomos ata të pasuksesshmit, është se jeta – vërtet – na ofron pikërisht aq sa prej saj kërkojmë. Prandaj, së pari duhet të pyetemi – çfarë, në të vërtetë, duam? Nëse kërkesat tuaja janë të padefinuara, ajo që do ta fitosh do të jetë po ashtu e paqartë. Nëse kërkon pak, pak do të fitosh. Dhe mos u befaso nëse aq fiton. Përfundimisht, atë e ke kërkuar.”

Milioneri ka vështruar se a po i përcillte djaloshi fjalët e tij dhe ka vazhduar:

“Çdo kërkesë që parashtron duhet të jetë e formuluar në të njëjtën mënyrë. Para së gjithash, duhet të jetë absolutisht precize. Sa i përket pasurisë, duhet ta caktojme shumë dhe afatin deri tek i cili atë sasi dëshirojmë ta fitojmë. Çfarë zakonisht bëjnë njerëzit? Madje edhe ata që e duan shumë paranë, i bëjnë të njëjtat gabime. Nëse nuk beson, vetëm pyete dikë sesa dëshiron saktësisht të fitojë vitin tjetër. Kërko të të përgjigjet menjëherë, rrufeshëm. Nëse ai person vërtet është në rrugën e suksesit, nëse vërtet e di se kah po shkon dhe nëse nuk ka

për t'i penguar që atë ta thotë, do të duhej ta kishte përgjigjen gati. Porse nëntë nga dhjetë persona thjesht nuk mund të përgjigjen menjëherë në këtë pyetje. E këtu është më së shumti gabimi. Jeta dëshiron të dijë – saktësisht – se çfarë kërkon prej saj. Nëse asgjë nuk kërkon, asgjë nuk ke për të fituar.”

“E tash eja ta bëjmë të njëjtin test edhe me ty”, ka vazhduar plaku. “Ke thënë se dëshiron të bëhesh i pasur.”

“Mu ashtu.”

“A mund të më thuash, atëherë, sesa dëshiron të fitosh vitin tjetër?”

Djaloshi përnjëherë e ka ndier se po i mungonin fjalët. Nuk e ka pasur të vështirë të përcillte mënyrën e të menduarit të plakut. Në të vërtetë, plotësisht është pajtuar me të. E tash ka qenë dashur ta pranojë se po i takonte shumicës absolute të njerëzve të cilët duan të pasurohen, por nuk dinë sa, në të vërtetë, duan të fitojnë. Ka qenë i hutuar dhe e ka mbuluar skuqja.

“Nuk di”, u detyrua të pranonte, “mendoj se pikërisht e kuptova njërin nga gabimet e mia – ndoshta më të madhin.”

“Kjo vërtet është gabim serioz. Të provojmë ta ndreqim. Hajde, shkruaje shumën që ke ndër mend.”

“Vërtet nuk di”, ka mermëritur djaloshi.

“E megjithatë, është aq lehtë. Shënoje sasinë që do të dëshiroje ta fitoje për një vit. Por, a di se çfarë do të bëjmë. Mendo për këtë disa minuta. Pastaj shkruaje sasinë.

Si afat e kemi lënë një vit. Krejt ajo për të cilën duhet të mendosh është sasia. Fillo – koha kalon.”

Duke e thënë këtë, e vendosi orën prej rëre mbi tavolinë dhe e ktheu.

Djaloshi frik e kuptoi rregullin e lojës, meqë për të parën herë në jetën e vet ka pasur detyrë aq të vështirë. Numra të shumtë absurdë i janë mbështjellë nëpër kokë. Koha ka kaluar. Kur kokrra e fundit e rërës ka rënë, akoma nuk ka mundur të vendosë për sasinë e caktuar.

“Po”, ka thënë Milioneri, i cili gjatë gjithë asaj kohe nuk i kishte shkoqur sytë nga ora prej rëre, “cilën sasi e ke në mendje?”

Djaloshi e ka shkruar sasinë të cilën e ka marrë si më së lehti të arritshme. Me dorën duke iu dridhur i ka shënuar numrat një nga një.

“Tridhjetë mijë funta”, ka përsëritur Milioneri. “Kjo është relativisht sasi e vogël – por edhe ashtu është vetëm fillimi. Do ta kisha pasur kënaqësinë po t’i kishe shënuar 300.000 funta. Duhet edhe shumëçka të punohet për t’u bërë instant milioner. Por, mirë. Nuk është kjo aq vështirë siç shumë njerëz e mendojnë. Megjithatë, kjo do të jetë puna më e rëndësishme në jetën tënde, pavarësisht se cilin profesion ke për ta zgjedhur. Kjo quhet puno pak në vetvete.”

## KREU 7

### Djaloshi njuh vlerën e imixhit të vet

Shërbëtori hyri për të sjellë kafetë. Djaloshi nuk kishte ngrënë për mëngjes, kurse trazimi emocional i mbrëmshëm ia kishte shtuar oreksin. Derisa ka ngrënë, të mësuarit ka vazhduar.

“Do t’i shtroj disa pyetje”, tha Instant Milioneri, “për të ndihmuar ta kuptosh atë që ka ngjarë në momentet e mendimeve të tua, të cilat t’u kanë dukur, sigurisht, shumë të shkurtëra.”

“Vërtet po.”

“E para që duhet ta dish është se shuma që ke shënuar në atë copëz letre ka domethënie shumë më tepër sesa ti mendon. Në të vërtetë, ajo shumë është çmimi yt i saktë. Në sytë e tu, pa marrë parasysh sesa ti je i gatshëm që ta pranosh, ti vlen 30.000 funta në vit. As më shumë, as më pak.”

“Nuk di pse e thua këtë”, ka theksuar djaloshi. “Fakti se kam zgjedhur pikërisht atë shumë domethënë se jam real dhe se me të dyja këmbët qëndroj fort në tokë. Tani për tani nuk di sesi kisha mundur të fitoj më tepër. Nuk kam diplomë, nuk kam punë të mirë dhe llogaria ime në bankë është saktësisht zero.”

“Të menduarit tënd pa dyshim është i drejtë – e respektoj. I vetmi problem është se të menduarit tënd është shkaktar i situatës tënde të tanishme. Rrethanat e jashtme

vërtet nuk kanë rëndësi të veçantë. Mbye mirë në mend këtë: të gjitha ngjarjet e jetës tënde, qofshin ato emocionale, shoqërore apo profesionale, janë pasqyrë e mendimeve të tua. Por, pasi që mendja jote ende nuk është e formuar, akoma nuk mund ta pranosh premisën e tillë. Mendja jote akoma e pranon iluzionin përgjithësisht të përhapur se faktorët e jashtëm kanë rol vendimtar në jetën tënde, derisa në realitet krejt është çështje stili. Jeta është pikërisht siç e mendojmë. Çdo gjë që të ndodhë, e kanë shkaktuar mendimet e tua. Dhe nëse dëshiron ta ndryshosh jetën tënde, duhet të fillosh të mendosh tjetërnryshe. S'ka dyshim se kjo duket ngapak banale. Shumë individë 'racionalistë' kokëfortësisht e kontestojnë këtë premisë."

Milioneri e ka kuptuar se djaloshi po observonte çdo fjalë të tij, ndaj ka shtuar:

"Të gjithë që kanë mbërritur në jetë gjëra të mëdha, pavarësisht se për çfarë lëmi është fjala, gjithmonë i kanë injoruar vërejtjet e mendimtarëve dhe intelektualëve. Pa marrë parasysh se çfarë kanë thënë, të menduarit e tyre në esencë është materialist. Ata pohojnë dhe diskutojnë. Por, në esencë, debatet e tyre janë kryesisht sterile."

"E megjithatë", ka vazhduar, "nuk guxon të mendosh se unë jam kundër inteligjencës. Përkundrazi. Të menduarit dhe logjika janë të domosdoshme për arritjen e suksesit. Por, nuk mjaftojnë. Ato duhet të jenë instrumente dhe shërbëtorë besnikë e asgjë më shumë. Sakaq, në shumicën e rasteve ato iu bëhen pengesa sukseseve të mëdha, të cilat i arrijnë vetëm ata që besojnë në fuqinë e

mendjes. Ata njerëz të suksesshëm kurrë nuk lejojnë që rrethanat së tepërmi t'i trazojnë dhe në mënyrë të çuditshme e tërheqin pasurinë. Po të mendosh, rrethanat në të cilat kanë hasur njerëzit e suksesshëm në të kaluarën nuk kanë qenë tjetërfare nga këto me të cilat ballafaqohen bashkëkohasit e tu. Edhe më shpesh, madje, rrethanat kanë qenë edhe më të rënda, por situata e tillë thjesht i ka shtyrë që edhe më shumë t'i shfrytëzojnë të gjitha forcat e brendshme. Të gjithë të cilët janë bërë të pasur kanë qenë të bindur se të tillë mund të jenë. Dhe pikërisht për këtë kanë patur sukses. Por, t'i kthehemi copës sonë të letrës”, ka përfunduar, “dhe të përgjigjemi në këtë pyetje. Ato 30.000 funta të cilat i ke shënuar - sigurisht kjo nuk është shuma e parë që të ka rënë ndër mend?”

“Jo, nuk është. Keni të drejtë.”

“Çfarë shume ka qenë ajo?”

“Në të vërtetë nuk mund ta them. Kokën e kam përplot numra.”

“Po, për shembull?”

“Paj, 50.000 funta.”

“Po pse atë sasi nuk e ke shkruar?”

“Nuk di. Më është dukur e paarritshme.”

“Ashtu do të jetë gjithnjë derisa nuk ke për të besuar se atë mund ta arrish. Pasi ke filluar me vetëm 30.000 funta, para nesh ka akoma edhe shumë punë – pra, do të jetë e nevojshme edhe shumë kohë për t'u bërë milioner. Prandaj, shkruaje shumën më të lartë e cila akoma të duket e realizueshme.”

Djaloshi e ka dëgjuar. Pasi që një moment është menduar, ka shënuar – 40.000 funta.

“Të përgëzoh”, është përgjigjur Instant Milioneri. “Pikërisht për disa sekonda ke fituar 10.000 funta. Nuk është keq.”

“Por akoma s’i kam fituar.”

“Si t’i kishe fituar. E ke bërë hapin më të madh. E ke zgjeruar fotografinë për veten duke menduar se mund t’i fitosh 40.000 në vend se 30.000 funta. Ky nuk është ndonjë kërcim i madh, por gjithsesi është një përparim. Përfundimisht, as Roma nuk është ndërtuar për një ditë. Në ty fshihet qyteti i panjohur, diçka si Roma – përgjithësisht si edhe në çdo krijesë njerëzore. Çuditërisht ai qytet është pikërisht ashtu siç e mendojmë. Është pabesueshmërisht fleksibil. Madhësinë ia ke përcaktuar ti vetë. Pak njerëz e dinë se ai qytet i brendshëm ekziston. Kufijtë të cilë ia ke vënë rëndom quhen “parafytyrimi për vetveten”. Duke i rritur numrat që i ke shkruar, e ke lëvizur procesin e zgjerimit të kufijve të qytetit tënd. Roma jote e brendshme automatikisht është rritur. Apo së paku ka filluar të rritet. Të gjithë mendimtarët e urtë me shekuj flasin se njeriu *vetë-vetes* mund t’ia imponojë kufizimet më të mëdha e se pengesat në kokë janë pengesat më të mëdha të çdo suksesi. Zgjerimi kufijtë e të menduarit tënd dhe ke për ta zgjeruar jetën tënde. Hidhi kufijtë e tu dhe ke për t’i hedhur kufijtë e jetës tënde. Jeta jote ka për t’u ndërruar. Këtë solemnisht po ta premtoj.”



“Por si mund ta di se cilët janë kufijtë mendimtarë?”, ka pyetur djaloshi. “Kjo po më duket e besueshme, por njëherit megjithatë abstrakte.”

“Pikërisht të kam treguar si ta gjesh kufirin që përkufizon mendjen tënde e i cili i përgjigjet parafytyrimit tënd për ty”, ka thënë Milioneri. “E ke konkretizuar atë kur e ke shkruar sasinë. Është fascinante të zbulosh se çfarë çdo individ vërtet mendon për vete. Secilën herë kur dikush e provon këtë, numri i thjeshtë menjëherë zbulon parafytyrimin për secilin individ. I ballafaquar është me kufizimet mendore të vetat dhe ato do të korrespondojnë me kufijtë të cilët do t’i ketë në jetë. Jeta ka për t’u gjunjëzuar para pengesave të cilat vetë individit vetvetes ia ka vënë – qoftë i vetëdijshëm për këtë apo jo. Është tragjike sesi njerëzit që rëndom nuk kanë sukses janë më së paku të vetëdijshëm për këto premisa themelore të suksesit e pasurisë. Dhe e kundërta, individët e suksesshëm janë bërë të vetëdijshëm për këtë fenomen dhe kanë bërë krejt çka ka qenë e mundur të punojnë në vetvete.”

“Më së lehti është që këtë ta bësh në fillim”, ka vazhduar duke shkruar në copën e letrës gradualisht numra gjithnjë e më të mëdhenj e më të mëdhenj. “Në çdo rast, një është e sigurt: Nuk mund të bëhesh i pasur nëse nuk je i bindur se mund të bëhesh. Parafytyrimi të cilin e krijon për vete duhet t’i përgjigjet përfytyrimit të personit që mund të bëhet i pasur. Ta përsërisim këtë ushtrimin tonë të vogël. Shkruaje një sasi shumë më të guximshme.”

Djaloshi ka menduar gjatë dhe shqetësueshëm, duke u lëkundur, ka shënuar 60.000 funta. Njëkohësisht e ka pranuar se kjo është maksimumi i fitimit të tij potencial.

“Noshta ky është maksimumi të cilin e shpreson, por ky sigurisht nuk është maksimumi të cilin mund ta fitosh. Kjo është sasi relativisht modeste. Disa njerëz këtë e fitojnë në muaj, disa në javë, disa madje edhe për një ditë – çdo ditë në muaj. Por, sidoqoftë – lejomë të të përgëzoj. Ke përparuar në mënyrë mahnitëse, e ke dyfishuar fotografinë për vetveten dhe dukshëm i ke zgjeruar kufijtë e tu shpirtërorë. Jo aq sa unë do të dëshiroja, por nuk dëshiroj të të shtyjë. Duhet t’ia fillosh ashtu që ta vësh qëllimin të cilin njëkohësisht e sheh edhe të guximshëm edhe të arsyeshëm. Përndryshe, do ta kesh vështirë që të besosh në të. E fshehta e qëllimit është se duhet të jetë edhe ambicioz edhe i arritshëm. Mos e harro këtë kur ta vësh qëllimin. Nga ana tjetër, mos harro as se shumica e njerëzve janë së tepërmi konzervativë. Frikësohen që hovshëm dhe gjerësisht t’i hapin kufijtë e vet shpirtërorë. I kanë shndërruar në një lloj shprehie. E kanë bërë shprehi ta jetojnë përditshmërinë e njëlllojtë. Janë të bindur se mu ajo është e tëra në jetë. Së tepërmi i frikësohen të ëndërruarit. Mos u frikëso t’i zgjerosh kufijtë e tu shpirtërorë. Veç me shkrimin e sasive gjithnjë e më të mëdha e më të mëdha, është mahnitëse sa mund të përparosh për një orë. Ia ke dalur që ta dyfishosh qëllimin tënd për gjithsej disa minuta.”

“Më vonë”, ka vazhduar, “kur të mbetesh vetë në dhomë, bëje ushtrimin tjetër: Shënoje zhvillimin e situatës tënde financiare.

Ja, si ke për ta bërë këtë. Shkruaj: për gjashtë vjet kam për t’u bërë milioner. Ndoshta do të kesh vërejtje në faktin se duhet pritur gjashtë vjet për t’u bërë milioner. Pajtohem, por të nevojitet vetëm sekonda që ta aktivizosh çelësin e brendshëm i cili ka për të ta ofruar sigurinë financiare dhe pasurinë.

Nëse mua më pyet, edhe pse ia kam filluar vetëm me dhjetë mijë funta të cilat m’i pati huazuar një milioner i vjetër, kanë kaluar saktësisht pesë vjet e nëntë muaj gjer tek milioni im i parë. Prej atëherë kam përparuar për çdo herë duke zbatuar të njëjtën formulë. Në këtë formulë njerëzit shpesh kanë shikuar me përqeshje. Dhe kjo nuk ka për t’u ndërruar. Por ata që më kanë përqeshur, nuk janë të pasur!”

Djaloshi i menduar ka luajtur kokën. Në të vërtetë, nuk ka ditur se çfarë të thoshte. Nuk ka qenë plotësisht i sigurt. Megjithatë, krejt kjo i është dukur aq e lehtë.

“Sigurisht”, ka vazhduar Instant Milioneri, “kjo formulë nuk vlen vetëm për ata që dëshirojnë të jenë milionerë. Përfundimisht, nuk ka secili ambicie të tilla. Dhe këtu pikërisht është bukuria e kësaj të fshehte. Është njësoj funksionale për të gjitha ëndrrat – prej atyre më të zakonshmeve e deri tek ato më ekstravagantet. Rezultati mund të jetë fitimi prej 5.000 funtash në vit apo fitimi yt mund të dyfishohet brenda vitit – çka përgjithësisht, është krejt e mundshme.

Nëse nuk ke asgjë kundër, eja në dhomën time dhe gjersa unë të merrem me trëndafilat e mi të mrekullueshëm, shkruaje në qetësi fjalinë që ta kam thënë: “Për gjashtë vjet kam për t’u bërë milioner dhe atë në këtë ditë.....”

Dhe atëherë shkruaje ditën, muajin, vitin. Shih ta shënosh çdo mendim që të bie ndër mend, pavarësisht se çfarë mund të jetë. Do të gjesh pak letra në tavolinë. Mbaje në mend – gjithnjë derisa nuk mësohesh me idenë se mund të bëhesh milioner, gjithnjë derisa kjo nuk është pjesë e jetës tënde, e së këndejmi edhe pjesë e mendimeve të tua më të fshehta, asgjë nuk do të ndihmojë për t’u bërë milioner. Shko tash dhe mendo për formulën time, e cila do të bëhet parim yti udhëheqës për gjashtë vjetët e ardhshme.

## KREU 8

### Djaloshi zbulon fuqinë e fjalës

Pas një ore shërbëtori ka ardhur te djaloshi, i cili as që e ka vënë re se ka kaluar aq shumë kohë, duke qenë i thelluar në detyrën të cilën ia kishte dhënë milioneri ekscentrik.

Shërbëtori i tha se Milioneri po e priste në kopsht, dhe duke mos folur asgjë, e ka dërguar atje.

Nikoqiri i tij ka qëndruar në ulësen e njëjtë, si edhe ditën e parë, dhe e ka soditur trëndafilin sapo të krasitur. Kur e ka dëgjuar djaloshin se po afrohej, e ka ngritur kokën. Është dukur si të ndodhej në frymëzim e sipër dhe ka qeshur me ëmbëlsi.

“Po ç’kemi?”, ka pyetur. “A ishte i suksesshëm ushtrimi?”

“Po. Por kam shumë pyetje.”

“Prandaj jemi këtu”.

E ka ftuar djaloshin t’i ulej pranë.

“Ajo që po më brengos më së tepërmi”, i ka thënë djaloshi plakut, “është fakti se kurrsesi nuk po mund ta kuptoj sesi për gjashtë vjet do të bëhem milioner, madje edhe në qoftë se këtë fjali të çmendur e shkruaj dhe për të mendoj pandalim. Pyetja ime është: Si të bindem se mund të bëhem milioner? Madje nuk di as se çfarë mund të punoj. Akoma mendoj se jam ende i ri për milioner.”

“Kjo nuk është pengesë. Njerëz të panumërt janë bërë milionerë kur kanë qenë më të rinj se ti. Vitet nuk janë pengesë. Pengesa më e madhe është të mos e dish fshehtësinë, apo kur ta mësosh, të mos e zbatosh.”

“Jam i gatshëm ta zbatoj. Vetëm se nuk shoh si ndonjëherë kam për t’u bindur se mund të bëhem milioner.”

“Ekziston, në të vërtetë, vetëm një mënyrë. Dhe kjo mu ajo e njëjta që e ke zbatuar kur je bindur se nuk mund të bëhesh milioner, madje edhe nëse atë e dëshiron. Në disa ditë të ardhshme, më së shumti disa javë, do ta zhvillosh në vetvete personalitetin e milionerit. Natyrisht, do të kalojë njëfarë kohe që të asgjësohet ajo që e ke ndërtuar me vite. Fshtësia ekziston në fjalët e kombinuara me fotografi me anë të së cilave mendimet vetvetiu shprehen në mënyrë të veçantë. Çdo mendim yti gjakon që në jetë të shfaqet në këtë apo në atë mënyrë. Sa më i fuqishëm të jetë karakteri i personit, aq më të fuqishme do të jenë mendimet e tij dhe do të realizohen më parë, duke i trajtësuar ashtu ngjarjet në jetën e tij. Kjo pa dyshim e ka inspiruar Heraklitin kur e ka thënë maksimën: *karakteri i përgjigjet fatit*. Dëshirat më së miri iu kundërvihen mendimeve të tua. Sa më të fuqishme ta kesh dëshirën, aq më shpejt do të ndodhin në jetë gjërat që i dëshiron. Rruga gjer te pasuria është: *që këtë ta duash me krejt zemrën*. Për sukses në të gjitha fushat e jetës kërkohet çiltërsi dhe dëshirë e zjarrtë.”

“Por unë, sinqerisht, gjithsesi dua të bëhem i pasur”, ka thënë djaloshi. “Me vite bëj krejt çka mundem. Por kurrfarë dobie nuk pashë.”

“Është e nevojshme dëshira e zjarrtë, por nuk mjafton. Ajo që po të mungon është besimi. Duhet të besosh se ke për t’u bërë milioner.”

“Si kam për ta besuar atë?”

“Për këtë kam lexuar shumë libra. Dhe ajo që në libra shkruan i përgjigjet asaj që ma ka mësuar mësuesi im. Rruga e vetme për të besuar është përsëritja e fjalëve. Fjalët kanë ndikim të jashtëzakonshëm në botën tonë të brendshme dhe të jashtme. Shumica e njerëzve nuk janë fare të vetëdijshëm për këtë parim dhe hezitojnë ta zbatojnë... Jo, ata, në të vërtetë, e shfrytëzojnë fuqinë e fjalës, por zakonisht në dëm të tyre. Fjalët janë të gjithëfuqishme.”

“Nuk dëshiroj të ju kundërvihem”, ka thënë djaloshi, “por mendoj se po e teproni. Nuk shoh, në të vërtetë, sesi fjalët mund të më ndihmojnë të bëhem milioner. Ato mund ta kenë ndonjë domethënie por, pajtohuni, se kjo është relative.”

Instant Milioneri nuk është përgjigjur në vërejtjen e djaloshtit. Ka qenë i preokupuar me mendimet e veta. Atëherë ka pohuar:

“Mbi tavolinë në dhomën tënde kam lënë një libërth të vjetër i cili detajisht e shpjegon këtë teori. Shko, të lutem, gjeje. Është shumë i vogël. Lexoje dhe kthehu. E vazhdojmë diskutimin tonë më vonë. Nëse të nevojitet qetësia, mbylli dyert e dhomës tënde.”

Djaloshi ka pranuar. Ka shkuar në dhomën e tij, e ka mbyllur derën dhe në tavolinë ka kërkuar libërthin. Nuk

ka pasur libërth. Në vend të tij, ka gjetur një letër e cila sigurisht ka qenë për të, edhe pse në të nuk ishte i shkruar emri i tij. Megjithatë, në të ka shkruar qartë: Letër për milionerin e ri. E ka hapur. Letra ka përmbajtur vetëm një fjalë të shkruar me ngjyrë të kuqe: “*Lamtumirë!*” Ka qenë e nënshkruar: Instant Milioneri.

Zemra e djaloshit ka zënë të rrahë si e çmendur.

Në atë çast e ka ndier një tingull. Është kthyer dhe ka parë kompjuterin që më parë nuk e kishte vënë re. Dikush me siguri e kishte vënë aty derisa kishte qenë përjashta. Printerit ka punuar. Djaloshi i është ofruar dhe ka zënë ta lexojë tekstin. E ka përmbajtur një fjali të vetme, të përsëritur disa herë:

TË KA MBETUR EDHE NJË ORË JETË

TË KA MBETUR EDHE NJË ORË JETË

TË KA MBETUR EDHE NJË ORË JETË

TË KA MBETUR EDHE NJË ORË JETË

Nëse kjo ka qenë mahi, ka qenë e pakripur. E megjithatë, duhet të jetë mahi. Pse Instant Milioneri do ta dëshironte vdekjen e tij. Djaloshi nuk i kishte bërë asgjë. Por këtu çdo gjë ishte aq e çuditshme. Ndoshta Milioneri është çerrata i cili fsheh qëllimet e veta kriminale nën maskën e qëllimmirësisë.

Djaloshi ka qenë shumë i hutuar. Ka qenë i sigurt vetëm për një gjë: që mahi apo jo, nuk do të rrezikonte. Dëshironte të ikte – për ta harruar çekun e vet, fshehtësinë dhe teoritë magjike të Milionerit të cilat ia kishin ndezur frymën e tij naive.



E ka hedhur letrën mbi dysHEME dhe është nisur kah dera, por ajo ka qenë fuqimisht e mbyllur. E ka zënë paniku. E ka trandur rezën duke provuar ta çilte derën me forcë, por pa sukses.

Djaloshi ka shkalluar. Ka vrapuar kah dritarja dhe ka parë Milionerin sesi e punonte kopshtin. Nuk ka menduar fare se a do të kishte kuptim apo jo, por ka bërë titur me krejt zërin. Nuk ka pasur përgjigje. Mos Milioneri është i shurdhët? Deri tash dukej se po dëgjonte. Shërbëtori është shfaqur në kopsht. Djaloshi e ka ftuar me zë buçitës, histerik, por ka qenë si t'i thërriste hënës.

Çfarë është ky ankth i tmerrshëm nëpër të cilin po kalon? Nuk është e mundur që të dytë të jenë të shurdhët.

I ka thirrur përsëri. Shërbëtori tjetër është shfaqur pas të parit. Edhe ai ka qenë krejtësisht indiferent në thirrjen e të burgosurit. Djaloshi për çdo moment është ndier gjithnjë e më i dëshpëruar. Duhet të ketë qenë ky kurth mirë i përgatitur dhe ai ka rënë drejt e në duart e armikut.

Përsëri ka menduar për arratisjen përmes dritares, siç pati menduar herën e parë kur qe mbyllur, por kjo i është dukur mjaft e rrezikshme; do të mund ta thyente qafën. Përnjëherë sytë i kanë shkuar te telefoni. Është krejt i krisur. Si nuk i është kujtuar kjo më parë? Kë do të mund ta ftonte? Policinë? Apo ta ftojë shërbimin urgjent? Çfarë nëse është krejt në rregull dhe ata ta akuzonin se i ka mashtruar?

Ka vendosur ta thërrasë centralin. Femra ka pasur zë tejet të pazakonshëm dhe kur e ka pyetur për numrin e stacionit më të afërt të policisë, ia ka dhënë. Menjëherë ka thirrur, por ka qenë lidhja e zënë. Çfarë zëri iritues. E ka zgjedhur përsëri. Akoma lidhja e zënë. Sot asgjë nuk po i shkon mbarë. Ka provuar edhe njëherë. Në çast ka vërejtur se po shikonte në numrin që po e thërriste – jo se ai e kishte shkruar, por sepse ai numër ishte i shënuar në telefon nga i cili thërriste. E ka thirrur dhomën e tij. Ja, seç ia kanë vënë samarin përsëri!

Ka provuar edhe njëherë me forcë ta hapte derën, por kot. Është kthyer prapë te dritarja. Ka vënë re sesi një njeri po i ofrohej shtëpisë. Mbante mantil të gjatë e të zi dhe sheshir të madh me majë. Djaloshi veçsa nuk ka vdekur nga frika. Kush do të mund të ishte përpos vrasësi i paguar që po vinte pas tij. Ka qenë i zënë si miu. Po vdiste. Nuk kishte shpëtim.

Së frikti i ka dëgjuar hapat që ngadalë po i ofroheshin derës. Paskan pasur të drejtë. Po troket ora e fundit. Është larguar nga dera duke kërkuar majtas e djathtas diçka me të cilin do të mund të mbrohej. Ka dëgjuar sesi po rrotullohej çelësi në derë. Reza ka lëvizur, dera është hapur. Në derë ka qëndruar hija e zezë e errët e cila në çast është shndërruar në figurë njeriu. Nuk ka folur asnjë fjalë. Vetëm ka qëndruar, duke mos lëvizur, si statujë. Përnjëherë njeriu e ka çuar dorën në xhep. Djaloshi ka menduar se po e nxirrte armën. Në vend të kësaj, vizitori misterioz ka nxjerrë një letër. Njëkohësisht ka ngritur

rrethin e sheshirit të tij dhe djaloshi, plotësisht i hipnotizuar, pa frymë, duke pritur më të keqen, e ka parë fytyrën e Milionerit me shprehje dashakeqësie.

“E ke harruar letrën në kopsht”, ka thënë Instant Milioneri, maskimi i të cilit tani për djaloshin, që veç kishte marrë frymë, i është dukur krejtësisht argëtues. “A e ke gjetur libërthin për të cilin të kam folur?”

“Jo, nuk e kam gjetur. Në vend të saj, e kam gjetur këtë”, është përgjigjur djaloshi, tashmë plotësisht i pajtuar nga toni miqësor i plakut.

Është kërrusur dhe ka marrë letrën nga dysHEMEJA.

“Cili është kuptimi i këtij skenari grotesk të cilin pikërisht sa e keni lozur?”, ka kërkuar sqarim djaloshi. “A e dini, se mund të ju padis...”

“Por... ato janë vetëm fjalë, vetëm disa fjalë të shkarravitura në një copëz letre. A do t’me kishe dërguar vërtet në gjyq shkaku i një cope të parëndësishme letre? Vallë, a s’më ke thënë se nuk beson në fuqinë e fjalës? Shiko se në çfarë gjendjeje je...”

Djaloshi në çast e ka kuptuar se për çfarë po fliste plaku.

“Vetëm kam dashur të ta mbaj një lekcion të shpejtë. Përvoja është mësues shumë më i mirë sesa teoria e pastër. Thënë thjesht, përvoja është jetë. A nuk ka qenë kjo filozofia e Gëtes? *E hirtë është ngjyra e teorisë, e gjelbër është ngjyra e drurit të jetës.*

A e kupton tani se ç’fuqi kanë fjalët?” ka vazhduar. “E edhe diçka: fuqia e tyre është aq e madhe saqë as nuk

duhet të jenë të vërteta për të ndikuar në njerëz. Të garantoj se në asnjë moment nuk kam pasur ndaj teje qëllime të këqija.”

“Si kam mundur ta di këtë?” ka pyetur djaloshi duke u qetësuar ngadalë.

“Ke mundur ta lodhësh kokën e të mendosh. Pse unë, o Zot, do të dëshiroja të të vrisja? Kurrë nuk më ke bërë asgjë të keqe. Madje edhe po të më kishe bërë keq, kurrë nuk do të kisha dëshiruar të hakmerrem. Krejt çfarë dua është të jem i lirë dhe të mund t’i kultivoj trëndafilat e mi të cilët janë vetëm shprehje e zbetë e kopshtit të tejmrekullueshëm që më pret. Ka qenë dashur të mbështetesh në kuptimin tënd për logjikë. A s’e ke vënë re, megjithatë, sesi logjika është e padobishme në situata çfarë është kjo? Kur na ke thirrur ne nga dritarja e dhomës tënde dhe ne jemi bërë kinse nuk po dëgjonim, ti vërtetë ke qenë i thyer. Gabimin që ke bërë nuk ka qenë në leximin e kërcënimit i cili ka qenë një trillim i kulluar, veçse shkaku se në të ke besuar. Kështu instiktivisht e ke dëgjuar njërin nga ligjet më të mëdha të cilët e udhëheqin mendjen njerëzore. Kur imagjinata dhe logjika i kundërvihen njëra-tjetrës, imagjinata gati gjithmonë dominon. Gabimi yt më i madhi është se e ke humbur toruan shkaku i kërcënimit i cili madje as nuk t’u ka dedikuar ty.”

Milioneri pastaj ka shkuar tek printeri, e ka ndalur dhe ia ka nxjerrë letrën. Ia ka treguar djaloshit që ka mbetur plotësisht i habitur kur ka parë se kërcënimi nuk i ishte dedikuar atij. Në krye të faqes është ndodhur emri i një të

huaji. Djaloshi është turpëruar. Krejt këtë e ka përjetuar vetëm shkaku i trillimit të imagjinatës së tij.

## KREU 9

### **Djaloshi për të parën herë e vëren zemrën e trëndafilin**

“Sot ke mësuar gjëra shumë të rëndësishme”, i ka thënë Milioneri djaloshit. “I ke kuptuar jo vetëm me kokën tënde, por edhe me zemër. Tani e di se fjalët thellësisht mund të ndikojnë në jetërat tona, deshëm apo nuk deshëm ne. Kërcënimi të cilin e ka shkruar kompjuteri nuk ka qenë për ty i dedikuar, por pa marrë parasysh këtë, pa nevojë je frikësuar dhe e ke humbur toruan... në të vërtetë jo pa nevojë, sepse e ke mësuar një mësim tepër të çmueshëm. Mendimi, qoftë edhe i gabueshëm, mund të ndikojë në ne nëse besojmë se është i vërtetë. Por, kur të mësojmë t’i dallojmë vlerat e mendimit, gjegjësisht vlerat që ne ia japim, mendja jonë përsëri bëhet e qetë, e ruan qetësinë. Mendja jote ka qenë ajo e cila i ka dhënë kuptim kërcënimit, se po të kishte qenë e shkruar në ndonjë gjuhë të huaj të cilën ti nuk e kupton, asaj nuk do t’ia kishe vënë mendjen fare.”

Milioneri ka heshtur që djaloshit t’i jepte kohë të kuptonte se ç’po thoshte. Një çast më vonë ka vazhduar: “Në të ardhmen, çdo herë kur ndishesh me problemin – e rruga drejt pasurisë është plot pengesa – përkujtoje këtë kërcënim. Thuaji vetvetes se problemi nuk ka lidhje me ty ashtu si edhe ai kërcënim. Ndoshta kjo të duket e

pazakonshme duke qenë se ti je ai i cili duhet ta zgjidhësh problemin. Binde veten se dikush tjetër ka për ta marrë atë brengë... orientoje dikah. Nuk di a jam sa duhet i qartë. Kurrë mos lejo që problemi në sytë e tu të bëhet aq i rëndësishëm saqë të të demoralizojë. Kur këtë ta kuptosh – e kjo nuk është e lehtë – të garantoj se ke për t’u bërë sundimtar i shkathtësisë tepër të çmueshme dhe do të mund t’i realizosh të gjitha ëndrrat e tua. Por, duhet ndërkaq të ta përkujtoj: rruga do të jetë e gjatë dhe e mundimshme. Por mos hiç dorë. Të premtoj se ka për t’u shpërblyer. Sakaq, ekziston shpresa se ndoshta një ditë madje edhe ke për ta kuptuar se ky është qëllimi i fundit në jetë – të tjerat janë të parëndësishme.”

Pasi e ka thënë porosinë e tij, Milioneri ka heshtur. Është dukur i thelluar në mendime. Shikimin e ka pasur plot pikëllim. Por megjithatë i ka shtuar edhe disa fjalë, si të ishin ato kapaku i të gjithave që deri më tani i kishte thënë:

“Jeta mund të jetë kopsht përplot trëndafila apo ferr në tokë, varësisht nga mënyra jote e mendimit. Mendo për trëndafilin. Kridhu në zemrën e trëndafilin çdo herë kur të shprërthen ndonjë problem. Dhe përkujtoje kërcënimin i cili i ishte dedikuar një tjetri. Nëse kështu dëshiron, problemi gjithmonë ka për t’u orientuar dikah tjetër.”

Theks të veçantë iu ka dhënë këtyre fjalëve: “Shumica e njerëzve nuk e kuptojnë pikërisht këtë që e kam thënë tash. Ata besojnë se ky është optimizëm i tepruar. Por kjo është shumë më e thellë. Kjo është një nga parimet më

të rëndësishme të mendjes. Për ata që nuk e shohin të keqen, e keqja nuk ekziston. Bota është vetëm shprehje e “unit” tonë të brendshëm. Kushtet e jetës tënde janë vetëm shprehje reale të jetës tënde të brendshme. Nëse nuk ke dobësi, apo çfarëdoqoftë që shkakton probleme apo të keqen, atëherë nuk mund të ndishesh me të keqen, e as që mund të të kërcënohet rreziku. Gjithmonë rishtas konfirmoje premisën themelore se e keqja nuk ekziston dhe koncentrohu në zemrën e trëndafilin. Aty do ta gjesh të vërtetën dhe njohjen e cila ka për të udhëhequr në jetë. Do të gjesh, po ashtu, diçka që është e rrallë në tokë: dashurinë ndaj çdo gjëje që punon dhe dashurinë për të tjerët. Kjo është fshehtësia dyfishe e pasurisë së vërtetë.”



## KREU 10

### **Djaloshi mëson sesi ta zotërojë ndërdijen e vet**

Pas këtij fjalimi të gjatë dhe bindës, është dukur sikur Milioneri plak është shterrur paksa dhe për disa minuta ka heshtur. Pastaj ka vazhduar, me kujdes duke theksuar secilën fjalë:

“Pikërisht për këtë formula që ta kam dhënë është aq e fuqishme. Madje edhe në qoftë se në fillim nuk beson se ndonjëherë ke për t’u bërë milioner, mund të bëhesh i tillë. Vetëm përsërite atë që bëre me letrën. Beso se ajo që po thuhet është e vërteta, sepse e fshehta më e madhe e të gjitha sukseseve të mëdha është – besimi. Nëse beson se diçka do të mund të arrish, sigurisht edhe ke për ta arritur.”

“Problemi im i vetëm është që të besoj se mund të bëhem milioner për pesë vjet. Në rastin e letrës, kam lejuar që të jem i mashtruar – e kam humbur toruan. Por kjo formulë është diçka krejt tjetër.”

“Madje edhe nëse nuk i beson formulës, ajo do të fillojë të ndikojë në ty. Sa më tepër ta përvetësosh, ka për të qenë aq më e fuqishme. Përparësia është aty se nuk duhet patjetër ta bindësh arsyen tënde apo vetëdijen. Kujto kërcënimin. T’u ka dukur absurd, dhe atë me arsye. Por, të themi ashtu, ka qenë ai më i fortë se ti. Një pjesë jotja – imagjinata jote – e ka pranuar atë kërcënim si të vërtetë.

Kurse imagjinata është ajo që disa njerëz e quajnë ndërdije. Ajo është pjesë e fshehur e mendjes sonë, shumë më e fuqishme se pjesa e dukshme. Ajo e udhëheq tërë jetën tonë. Me orë mund të të flas për teorinë e së ndërdijshmes. Por, mjafton të dish se ndërdija është jashtëzakonisht e ndieshme në forcën e fjalës. A di se pse e ke aq të vështirë të besosh në faktin shumë të mundshëm dhe lehtë të realizueshëm se mund të bëhesh milioner për më pak se gjashtë vjet?”

“Mjerisht, nuk e di.”

“Fakti është se me vite fjalitë dhe mendimet – gjegjësisht fjalët – janë skalitur në ndërdijen tënde. Thellë. Në të vërtetë, çdo përvojë jotja, secili mendim yti, secila fjalë që ndonjëherë e ke dëgjuar, ka mbetur e skalitur në ndërdijen tënde. Ajo “memorje” kolosale e grumbulluar për një kohë të gjatë bëhet fotografia personale e çdo individi. Edhe pse për të nuk je i vetëdijshëm, përvojat e tua të kaluara dhe monologu yt i brendshëm të kanë bindur se ti nuk je personi që mund të bëhet milioner, edhe pse, nëse flasim objektivisht, i ke për këtë të gjithja kualitetet dhe kjo është më lehtë sesa mendon. Si tek secili person, fotografia jote personale për vetveten është aq e fuqishme saqë ndërdijshëm bëhet fat yti. Rrethanat e jashtme më në fund, me precizitet të habitshëm, i përgjigjen fotografisë që ke për veten. Për t’u bërë pasanik duhet të krijosh fotografi të re për veten.”

“Jam i sigurt se mundem, por kjo ende nuk ma zgjidh problemin tim. Plotësisht jam i gatshëm t’i pranoj të

gjitha këto teori. Vështirësia e vetme është se nuk po shoh sesi ta bind veten se mund të jem milioner.”

“Kjo është lehtë, a nuk po e vëren, vallë? Mendo për kërcënimin e mëhershëm. Nuk ka qenë i vërtetë, por në ty ka vepruar si të ishte i tillë. Krejt çka duhet bërë është që ta zbatosh trikun e njëjtë. Ndërdija jote edhe sa i përket këtij rasti nuk do të jetë aspak më e mençur. Kur ke qenë fëmijë, po edhe më vonë, çdo herë kur e ke pranuar sugjestionin, qoftë ai edhe i gabueshëm, realisht e ke mashtruar ndërdijen tënde. Në secilin rast e ke detyruar të pranohet diçka që ka qenë ashiqare jo e vërtetë. Edhe tash ke për ta bërë të njëjtën gjë. Në ndërdijen tënde mund të ndikosh me pretendim. Njëherë kur të ndikosh në të, ashtu siç dëshiron, që realisht është shumë e thjeshtë, mund të marrësh prej jetës saktësisht atë që dëshiron. Pse? Për arsye se ndërdija jote do të jetë e bindur se krejt ato *mund* t’i arrish. Do t’i pranosh të gjitha ato si të vërteta në të njëjtën mënyrë siç tashi e pranon faktin se nuk mund të arrish më tepër. Kjo lidhet me atë që kam thënë më heret. Njeriu është shprehje e mendimeve të grumbulluara në ndërdije.”

Duke e ndier se djaloshi gjithnjë e më tepër ishte i interesuar për fjalët e tija, Milioneri ka vendosur të vazhdojë.

“Gjëja më e rëndësishme është që të shtiresh se është diçka e vërtetë. Pse ajo ndikon në ndërdije? Thjesht shkakun se, more sado që është e fuqishme, ndërdija nuk mund ta dallojë të vërtetën nga rrena. Mendo për kërcënimin e mëngjesit. Ndërdija jote nuk ka mundur ta

dallojë atë që është dhe atë që nuk është e vërteta objektive. Dhe reagimi ka qenë tepër specifik. Po qe se mendja jote nuk do ta pranonte sugjestionin nga letra – po t'ia kishe mbyllur dyert ndërdijes – nuk kishte për të ardhur gjer tek reaksionet aq të fuqishme. Do të kishe mbetur plotësisht i qetë dhe do të kishe pritur që situata vetë të sqarohet.”

“Po, por çfarë ndodh nëse ekziston konflikt në mes të vetëdijes dhe ndërdijes? Çfarë ndodh kur pjesa ime e vetëdijshme refuzon ta pranojë idenë e pasurimit?”

“Zgjidhja e vetme, e përpos kësaj edhe më e mira e pa dyshim edhe më e shpejta, është përsëritja.”

“Përsëritja?”

“Ashtu është. Kjo metodë rëndom quhet autosugjestionin. Secili prej nesh gjatë jetës i nënshtrohet kësaj. Monologu i brendshëm të cilin secili prej nesh e bën, e formëson jetën tonë. Disa prej nesh gjithnjë ia përsërisin vetvetes se kurrë nuk kanë për të qenë të suksesshëm, sepse kanë rrjedhur nga familjet e humbësve apo shkaku i moskësësive që në sytë e tyre duken të kobshme. Dhe ashtu grumbullohen moskësës pas moskësës, jo për atë se nuk i kemi kualitetet e nevojshme për sukses, por për shkak se ndërdijshëm ashtu i shohim.”

“Disa meshkuj besojnë se kurrë nuk mund ta tërheqin femrën”, ka vazhduar Milioneri, “dhe ata thjesht e fshehin sharmin e tyre. Për këtë apo për atë arsye femrat prej tyre ikin si prej murtajës. Fuqia e *imixhit* të tyre personal, që është shprehje e ndërdijes, është përsëri

përgjegjëse për këtë. Ai të sjellë gjer tek rrethanat e tilla që i shtyn femrat të ikin prej njerëzve të tillë.”

“Por *përsëritja e formulave të tilla*”, ka konstatuar, “që kanë ndikim aq të madh në jetën tonë, mund të përdoret tjetërndryshe. Dhe kjo është ajo që ne do ta bëjmë. Ndërdija është rob që mund të na sundojë ne, sepse është jashtëzakonisht e fuqishme. Por, po ashtu, është e verbër dhe duhet të mësoh sesi ta shalosh.”

“Do të ishte tepër të thuhej se djaloshi i ka kuptuar tëra ato që i ka thënë Milioneri, por përshtypja e përgjithshme e tij për to ka qenë pozitive. E ka ndier se plaku po sqaronte për problemin e tij dhe dëshironte të mësonte sa më tepër.

“Bukuria e kësaj teorie qëndron në faktin se në të vërtetë nuk është patjetër të besosh në të për ta zbatuar”, ka thënë Milioneri. “Por, për të dhënë rezultate, duhet ta zbatosh – rezultatet nuk vijnë dot me magji, vetë nga vetja. Fshehtësia është e thjeshtë: e tëra, siç kam thënë, varet prej përsëritjes. Madje edhe në qoftë se në fillim në to nuk beson, provo që për disa ditë t’i zbatosh ato. Kjo mjafton sa për t’i parë rezultatet.

“Kjo formulë mund të të duket shumë e thjeshtë”, ka vazhduar, “por më lejo të të them se kjo është teoria më e fuqishme në botë. Kujtoji fjalët nga Bibla: “Në fillim ishte fjala”. Fjala, kjo don të thotë të folurit. Autosugjestionin ka rol të rëndësishëm në jetën tonë. Nëse për këtë nuk je i vetëdijshëm, më shpesh ka për të vepruar kundër teje sesa për të mirën tënde. Përkundrazi, nëse

vendos ta shfrytëzosh tërë forcën e tij kolosale, do ta kesh gjithnjë në dispozicion.”

“Mendoj se më keni bindur – edhe pse, të jem i sigurtë, akoma nuk di shumë për këtë teori”, ka thënë djaloshi.

“Në rregull. Qe çfarë duhet të punosh. Përsëri në fillim do të të duket shumë lehtë, por të menduarit tënd duhet ta konstituosh sipas rezultateve që realizon, e jo në bazë të kriterëve intelektuale...”

## KREU 11

### **Djaloshi dhe mentori i tij diskutojnë për numrat dhe formulat**

Milioni është ulur pranë tavolinës dhe e ka ftuar djaloshin t'i bashkangjitet. Ka marrë lapsin dhe letrën dhe i ka shkruar disa numra. “Formula jote mund të duket kështu”, ka sqaruar. Ka shënuar: *“Deri në fund të këtij viti do t'i kem 31.250 funta. Kam për ta dyfishuar pasurinë për çdo vit gjatë pesë vjetëve të ardhshme dhe atëherë (dhe këtu ka lënë hapësirë të zbrazët) kam për t'u bërë milioner.”*

“Nuk guxon ta ngatërrosh pasurinë me fitimin”, ia ka tërhequr vërejtjen djaloshit. “Pronë jotja është krejt ajo që të mbetet pasi ta paguash tatimin dhe shpenzimet rrjedhëse. Mund të përfshijë investimet në pronë të patundshme, në aksione, ndërmarrje, kursimet në bankë... Nëse dëshiron të bëhesh milioner për gjashtë vjet – që është afat real të cilin ta propozoj – formula jote duhet t'i përshtatet atij modeli. Nëse e ke pasurinë me vlerë prej 31.250 funtash në fund të vitit të parë, duhet gjithsesi që në fund të çdo viti ta dyfishosh. Dhe për gjashtë vjet, bëhesh milioner!

“Pse ta dyfishosh pasurinë tënde për çdo vit? Sepse ky është veprim i thjeshtë me të cilin ndërvoja mund të udhëheqë. Edhe ti e ke më lehtë ta mbash në mend. Kjo të

garanton rritë të përhershme. Kështu nuk do t'i ekspozohesh rrezikut që ta presësh vitin e shtatë për t'u bërë milioner.”

“Përveç kësaj”, ka vazhduar, “formula e re është praktikisht e pashmangshme nëse dëshiron të bëhesh milioner për një perudhë aq të shkurtër prej gjashtë vjetësh. Por ndoshta nuk do të mund ta realizosh pasurinë prej 31.250 funtash gjer në fund të vitit të parë, e të cilën do ta dyfishoje vitin tjetër. Nëse fillimi të duket së tepërmi ambicioz, atëherë zgjate afatin për një vit. Të bëhesh milioner për shtatë vjet akoma është mjaft mirë! Synimi yt për vitin e parë do të ishte 15.625 funta. Më beso kur të them se kjo është fare mirë e realizueshme. Nëse beson se ngadalë mund të vish gjer tek kursimet prej 15.625 funtash gjer në fund të vitit të parë, edhe do t'i kesh.

Nëse kjo të duket së tepërmi ambicioze, zgjate afatin edhe për një vit, që don të thotë tetë. Atëherë qëllimi në vitin tënd të parë do të ishte 7.812,50 funta.

Në formulën tënde: *KAM PËR T'U BËRË MILIONER* në ditën (vendose muajin dhe vitin, për pesë, shtatë apo dhjetë vjet), vendosi po ashtu qëllimet afatshkurtëra, udhërrëfyesit të cilët kanë për të frymëzuar në rrugën drejt pasurisë. Dhe, natyrisht, me rëndësi është qëllimi vjetor.”

“Më e rëndësishmja është”, i ka thënë nxënësit të vet, “t'i shkruash qëllimet e tua në letër. Merre lapsin dhe luaj me numra dhe vite. Mos u frikëso. Nuk mund të kesh dëm. Shumat kanë për të t'u bërë gjithnjë e më të afërta



gjersa me to do të bësh lojë. Mijëra njerëz dëshirojnë të pasurohen, por asnjëri prej qindërave nuk e merr nisjativën ta skicojë mënyrën në të cilën dëshiron ta arrijë qëllimin e vet. Ji tjetërnryshe. Bëje planin dhe skicën. Mendo gjithnjë derisa nuk vjen te plani që të përgjigjet. Ai ka për të qenë plani yt. Për inspirim përdor shembujt që t'i kam dhënë, e atëherë hidhju imagjinatës në gji. Duhet t'ia fillosh me ëndrrat për atë sesi të pasurohesh. Duhet të dish sesi në mënyrë kuantitative ta përcaktosh ëndrrën tënde, duke e përkthyer në sasi të hollash dhe në data. Kjo, në të vërtetë, duhet të jetë ushtrimi yt i parë. Luaj me numra. Së frikti ke për të parë se ajo lojë e vogël do të zbulojë se kush je në të vërtetë.

Veprimi i thjeshtë i vënies së qëllimeve, i afateve dhe shumave në letër, është hapi i parë kah transformimi i idealeve të tua në ekuivalencë materiale.

Secili që dëshiron ta realizojë ambicien për t'u bërë milioner për 5 apo 10 vjet, duhet t'ua kushtojë vëmendjen këtyre fakteve pasuese: nëse në këtë moment i fiton 20.000 funta në vit dhe nuk pret më tepër se, ta zëmë, rritja vjetore prej 10%, atëherë kurrë nuk ka për t'u bërë milioner nëse mbetet në atë punë, përpos nëse nuk bën punë shtesë.

Nuk ka aty kurrgjë dramatike apo të vlefshme të gjykohet. Ajo është vetëm vrojtim objektiv. Formula e dyfishimit të pasurisë personale për çdo vit apo shtimi i pasurisë në raport me vitin paraprak, nuk është natyrisht mënyra e vetme për t'u bërë milioner. Porse, e fshehta që ajo bart në vete qëndron aty se vënia kuantitative e qëllimit

(shuma dhe afati deri kur ajo do të arrihet) – vlen për secilin që dëshiron të ketë sukses.

Për shembull, ndoshta dëshiron ta rrisësh fitimin vetëm për 5.000 funta në vit. Nëse tash i fiton 25.000 funta, sigurisht do të dëshiroje t'i fitoje 30.000 funta – dëshiron, pra, t'ia lejosh vetes pak më tepër luks. Apo ndoshta tash fiton 30.000 funta e dëshiron t'i fitosh 40.000 për të mundur të tregtosh nga shtëpia jote e tashme, duke mos u brengosur për ekstra-këstet vjetore të kredisë hipotekore. Ndoshta do t'ia lejoje vetes edhe automobilin e ri, pak më luksoz.

Pikërisht kësaj i shërben kjo formulë kaq e thjeshtë. Thjesht përsërite: **KËTË VIT KAM PËR T'I RRRITUR TË ATDHURAT PËR 5.000 FUNTA (apo 10.000 funta) DHE KAM PËR TË FITUAR 30.000 (apo 40.000), varësisht nga dëshira.**

S'është patjetër të dish sesi ke për ta arritur atë. Vetëm duhet të kuptosh se nëse në vendin tënd të tashëm të punës mund të shpresosh për rritje prej 10% në vit, atëherë, në rast se eventualisht nuk dëshiron të merresh me kriminalitet, duhet ta sigurosh avansimin apo ta ndërrosh punën për ta arritur qëllimin e përcaktuar. Kjo ndoshta duket e qartë, por mijëra njerëz e shpresojnë përmirësimin e situatës materiale, kurse lidhur me të asgjë nuk ndërmarrin. A është kjo padituri? A është kjo shkak se në esencë janë të kënaqur me situatën e tyre madje edhe atëherë kur gjithnjë ankohen?

Njëherë kur ta kuptosh se të nevojitet ndryshimi në jetën tënde për ta arritur qëllimin, ti ndoshta ke për ta pyetur veten se – si, o Zot, kam për t’i fituar ato 5.000 apo 10.000 funta më tepër, që më nevojiten, por mos u brengos! Ky nuk është problem serioz. Me rëndësi është që me qëllimin tënd të depërtosh thellë në ndërdijen tënde, e t’i shkruash sasi të e afatet e caktuara. Ndërdija jote ka për ta kryer pjesën tjetër të punës. Përgatitu për aksion. Dhe kur të bëhesh i vetëdijshëm se gjërat nuk rregullohen prej vetvetes, pranoje, pa kurrfarë lëkundjeje, rastin e papritur. Mos lejo të të paralizojë frika, e cila i pengon shumë njerëz t’i realizojnë ëndrrat e tyre. E di se duhet diçka të ndërmarrësh për ta fituar tepërcën. Prandaj nuk guxon të hamendesh, por duhet t’i ndërmarrësh hapat e nevojshëm për ta arritur qëllimin tënd.

Ndërdija jote korrektësisht e programuar ka për të bërë çudira për ty. Nëse e ke skicuar rritjen e fitimit tënd për 10.000 funta, ndërdija jote sigurisht ka për të gjetur mënyra për ta realizuar atë. Çdo ditë mendo për të ashtu që ajo detyrë të të bëhet opsion i përditshëm. Ndërdija jote, si e udhëhequr me mekanizmin e dirigjimit nga largësia, ka për t’i anashkaluar të gjitha pengesat të cilat qëndrojnë në rrugën drejt qëllimit. Detyra jote është që hollësisht t’i organizosh të gjitha detajet.”

“Ç’është qëllimi?”, ka vazhduar. “Kur ka për të ardhur gjer tek eksplodimi? Qëllimi është 10.000 funtëshi, kurse data e eksploimit – fundi i vitit. Të këtilla janë

forcat magjike të ndërrijes dhe të qëllimit të përcaktuar kuantitativisht.

Kur t'i përcaktosh qëllimet, kije në mend se shumica e njerëzve janë relativisht të kujdesshëm. Pse? Sepse nuk besojnë se diçka vlejnë. Fotografia e tyre personale për veten është shumë e keqe.”

Në këtë moment të ligjërit, Milionerit i është dukur e përshtatshme ta ilustrojë teorinë e tij me një anekdotë të shkurtër personale.

“Para disa vitesh”, i ka pëshpëritur me besim djaloshit, “kam menduar ta punësoj drejtorin kryesor në njërën nga fabrikat e mia. Kam llogaritur se mund t’ia ofroj 45.000 funta. Kur ka ardhur koha e bisedimit për rrogën, më ka thënë me ton relativisht të rreptë, nervoz, e gati urdhërues: “Nuk kam për të pranuar asgjë më pak se 30.000 funta.”

Pas një pauze të gjatë, sikur t’i bëja shërbim të madh, kam thënë: “Në raport me kualitetet e tua kjo do të ishte në rregull.”

Po t’i kishte kërkuar 35.000 funta, do t’ia kisha dhënë. Po ashtu edhe 40.000 e madje edhe 45.000 funta, meqë edhe para bisedës kam qenë i gatshëm të jap aq. Përpos kësaj, kam qenë aq i kënaqur me bisedën saqë kam mundur madje ta ngris edhe në 50.000 funta.

Dhe ashtu personi që kam marrë në shërbim për disa minuta i ka humbur 20.000 funta. Kjo është para e madhe. Vetëm mendo – kjo do të thotë 20.000 funta vetëm në dhjetë vitet e para.

Pse i ka humbur aq para? Thjesht shkakun se nuk ka besuar se vlen 50.000 funta në vit. Më duhet pranuar se kur e kam dëgjuar se ç'rrogë priste, një pjesë sekonde jam hamendur dhe për pak sa nuk e kam refuzuar. Ai më së miri ka mundur ta vlerësojë vlerën e vet, sakaq më ka thënë se aftësitë e tij menaxhuese i vlenin vetëm 30.000 funta, derisa unë kam kërkuar dikë, aftësitë e të cilit do të vlenin 45.000. A kam bërë zgjedhje të keqe? Ardhmëria ka treguar se kam bërë zgjedhje të mirë që e kam marrë dhe ashtu kam kursyer shumë para. Problemi i tij ka qenë në faktin se i ka munguar vetëbesimi dhe e ka nënçmuar vlerën e vet. Gradualisht gjatë viteve e ka zgjidhur atë problem – që më ka kushtuar disa teprica të ardhurash. Por, e kanë vlejtur atë...

Atë që duhet ta mbash në mend prej këtij shembulli të thjeshtë është se unë jam sjellë ndaj atij menaxheri ashtu siç jeta sillet ndaj secilit prej nesh. Jeta na jep pikërisht aq sa prej saj presim. As më shumë, as më pak. Harrojmë se është e gatshme të na japë shumë më tepër sesa ne mendojmë, apo seç jemi mësuar të kërkojmë.”

“Shumë kam folur”, ka konstatuar Milioneri. “Çfarë mendon për tëra këto, djalosh?”

“Po duket tepër mirë për të qenë e vërtetë”, ka theksuar, edhe pse e ka thithur secilën fjalë që Milioneri e ka thënë.

“Megjithatë është ajo metodë thjeshtësisht e vogël dhe asgjë më tepër”, është përgjigjur, “pikërisht ajo që më ka ndihmuar të bëhem milioner e iu ka ndihmuar të gjithëve

që ua kam zbuluar këtë metodë. Fjalët kanë fuqi të madhe. Sa më i fortë të jetë personaliteti yt, për aq fjalët që flet fitojnë në peshë. Krejt ato që i pohon, të nxehura me besim të thellë të brendshëm dhe të fuqizuara me flakën e të përsëriturit, do të formësohen gjithnjë e më shpejt.”

“Gjersa po dëgjoj sesi e tregoni teorinë tuaj në vijat themelore, po e pyes veten se mos kjo është vetëm lojë e thjeshtë?” e ka ndërprerë djaloshi.

“Ndoshta. Por gjithsesi duhet të ushtrosh. Askush këtë nuk mund ta bëjë në vend tëndin. Duhet ditë e natë me zë ta përsërisësh formulën tënde, më së paku pesëdhjetë herë. Bile edhe njëqind herë nëse mundesh. Kjo është esenca e ushtrimit. Disa herë në fillim atë e kam bërë shtriras dhe kam numëruar duke iu rënë gishtërinjve për dysHEME, pesë herë me të dya duart. Duhet të pranosh që ta ushtrosh këtë.

Në fillim nuk ka për t’u dukur lehtë. Mendja është e prirur të bredhë. Pasi ta përsërisësh dhjetë herë, do të fillosh të mendosh për diçka tjetër. Kthehu mbrapa në punë dhe përsëri ia fillo nga zeroja, gjersa nuk ia del që të mbërrish në pesëdhjetë. Nëse nuk mund ta arrish atë trajtë themelore të disiplinës, më mirë hiç dorë nga ëndrra jote për t’u bërë pasanik... Kjo është sfida që ta ofroj, miku im. Dhe e di se këtë mundesh. Krejt çka e ke patjetër është – të qëndrosh.”

“Pse formula të përsëritet me zë?”

“Kjo më fuqishëm ndikon në mendjen tënde. Urdhresa të cilën ia jep ndërdijes tënde, duket sikur vjen prej së jashtmi, ndaj peshën urdhëruese do ta ketë më të

madhe. Thuaje atë në mënyrë monotone, shqiptoje mirë. Fole formulën ngjashëm me fallxhoret apo siç thuhet mantrat, siç atyre iu thonë budistët. Me kohë ajo formulë ka për t'u pavarësuar.”

Djaloshi ka qenë i impresionuar me fjalët e Milionerit. Plaku nuk ka qeshur më. Ka folur seriozisht, fjalët kanë kumbuar si profeci.

“Në fillim ndoshta do të jesh i hutuar me tingullin e zërit tënd dhe me formulën të cilën do ta përsërisësh. Por gradualisht ke për t'u mësuar. Qëllimi të cilin para vetes e ke vënë, i cili në fillim të është dukur i guximshëm, ka për t'u dukur i arritshëm, madje edhe qesharakisht i lehtë.”

“A nuk po mendoni, vallë, se në çastet e caktuara do të mund t'ia filloj të qesh me absurditetin e gjithë kësaj?”

“Pikërisht në ato momente, më shumë se në të tjerat, duhet të jesh rezistent. Duhet t'i mundësh dyshimet e tua. Më mendo mua. Do të jem me ty në secilin moment, madje edhe kur do të jem në kopshtin tim, larg prej teje. Edhe forca ime do të jetë me ty. Në çastet e dyshimeve të tua, kujtoje betimin që ke bërë para meje. Ke për të pasur sukses!”

“A jeni të sigurt në këtë?”, ka pyetur djaloshti, akoma jo sa duhet i bindur.

“E pse do të dyshoja? Bëhesh Instant Milioner siç jam bërë edhe unë. Pos kësaj, ti veç je bërë ai, kur e ke kuptuar dhe e ke pranuar parimin. Ligji i fshehtë i jetës është se secili që i kupton parimet e vërteta, fiton forcë. Ajo njohuri ka për të ta dhënë lirinë. Është vetëm çështje kohe

që vërtet të bëhesh milioner. Ti veçse je milioner në mendimet e tua, dhe ajo është më me rëndësi se çdo gjë.”

“Por nuk kam asnjë pen në llogarinë time...”

“Prandaj, gjithnjë përsërite formulën e fshehtë. Pak nga pak, dhe ke për të vënë re ndryshimet në ty. Qëllimi yt ka për t’u dukur gjithnjë e më i natyrshëm. Ka për t’u bërë pjesë e jetës tënde, njësoj siç edhe deri tash imixhi yt ka qenë pjesë e qenies sate, edhe pse ai është trillim i imagjinatës tënde. Shfaqjet e mendjes tënde nga e kaluara mund të riformulohen më mënyrë të re. Dhe kështu do të mund ta formësosh ardhmërinë tënde në mënyrën në të cilën ti dëshiron – më në fund ke për ta zotëruar fatin tënd. A nuk është kjo vallë ëndrra e fshehtë e çdo njeriu, madje edhe kur këtë s’e pranon?”

Djaloshi është pajtuar. Ka qenë i vërshuar nga emocionet. I është dukur sikur thëniet e plakut kishin shumë më tepër domethënie sesa që i ishte dukur në fillim. Natyrisht se metodat i ka pasur paksa të çuditshme. Por, mos vallë kjo është me rëndësi, kur ato janë funksionale?



## KREU 12

### Djaloshi mëson për fatin dhe jetën

“Për të ndihmuar dhe përkrahur”, i ka thënë Instant Milioneri nxënësit të tij të ri, “do ta jap tash një formulë pak më të përgjithshme. Prej saj në jetë do të kesh dobi. Ke për t’u transformuar përbrenda dhe përjashta. Në të vërtetë – ka për ta mundësuar të fitosh pasuri të vërtetë – e cila nuk është vetëm fitim i të mirave materiale. Është më pak specifike se ato. Kjo është pikëpamja mentale mbi jetën.”

“Më lejo të t’i jap disa këshilla”, ka vazhduar. “Natyrisht, formula jote monetare do të ta mundësojë t’i arrish e sigurisht edhe t’i tejkalosh qëllimet e tua financiare. Porse, gjatë kohës së hulumtimit tënd pas pasurisë kurrë mos e hiç nga mendja se, po u bëre i palumtur, do t’i humbasësh të gjitha. Gjakimi për paranë lehtë mund të shndërrohet në opsionin e cili ta pamundëson të kënaqesh në jetë. Siç thotë fjala e urtë: “Ç’dobi ka njeriu nëse e fiton krejt botën, por e humb shpirtin e vet?” Kjo pyetje mund t’u shkaktojë të qeshura disave që mendojnë se kjo është së tepërmi metafizike dhe religjioze. Por unë jam plotësisht i bindur se paraja është shërbëtor i shkëlqyeshëm, por zotëri tiranik.”

“Vallë, po mendoni se njëkohësisht njeriu nuk mund të jetë i lumtur dhe i pasur?”

“Qoftë larg. Por duhet gjithmonë të kesh kujdes që paraja të mos e robërojë mendjen tënde. Xhon D. Rokfeler,

në kohën e vet, njeriu më i pasur në botë, ka qenë aq i ngarkuar, aq i thithur nga brengat, saqë në moshën 50 vjeçare ka qenë plak i mjerë dhe, nëse mund të shprehemi ashtu, i dënuar me vdekje. Lukthi nuk i ka funksionuar dhe ka jetuar vetëm me bukë e tambël. Ka jetuar në frikë të përjetshme se mos po i humbet paratë e se mos kolegët e vet po e mashtrojnë. Paraja e ka zotëruar atë dhe ai më nuk ka mundur të kënaqet. Në njëfarë mënyre ai ka qenë më i varfër sesa një nëpunës i rëndomtë i cili së paku ka mundur të kënaqet me ushqim të mirë.”

“Derisa para hundës po ma vërtitni pasurinë”, ka thënë djaloshi, “njëkohësisht dëshironi të më frikësoni.”

“Dorën në zemër, këtë nuk e kam për qëllim”, është përgjigjur Milioneri, “dhe formula që kam për ta dhënë ka për të ndihmuar t’i ikësh kurthit në të cilin kanë rënë shumë gjuetarë të pasurisë. Njerëzit që akoma esencialisht janë skamnorë, mundohen pa shpirt që t’i arrijnë qëllimet. Paraja e parë që e fitojnë zgjon ambicien e tyre të rrënjosur, duke i joshur të gjakojnë pasuri sa më të madhe. E kur të fillojnë të fitojnë me të madhe, përnjëherësh i kaplon frika se mos atë po e humbasin.

Formula ime është e thjeshtë. Kjo është varianti i formulës së famshme të cilën e ka farkuar mjeku Emil Kue për pacientët e klinikës së vet: **PËR ÇDO DITË, NË ÇDO ASPEKT, PËRPAROJ GJITHNJË E MË SHUMË.**

Përsërite këtë formulë me zë pesëdhjetë herë në mëngjes dhe në mbrëmje dhe sa më shumë herë gjatë ditës.

Sa më shpesh që ke për ta përsëritur, aq më fuqishëm do të ndikojë në ty.”

Djaloshi i papërvojë tërësisht është shndërruar në vesh duke e dëgjuar plakun e urtë, i cili prore ka kundruar sesi para sysh i ka kaluar jeta e tij, kurse jetën e ka pasur të përmbushur dhe kryesisht të lumtur. Derisa ka qëndruar para tij, e ka ndier se ai ka qenë njeriu i parë i lumtur të cilin e ka njohur në jetën e vet.

“Shumica e njerëzve donë të jenë të lumtur”, ka vazhduar Milioneri, “por nuk dinë se ç’kërkojnë. Dhe kështu vdesin pashmangshmërisht, lumturinë kurrë pa e gjetur. E madje edhe kur ta gjejnë, duke qenë se nuk dinë se çfarë kërkojnë, nuk mund ta njohin. Ata janë njësoj si edhe njerëzit që kërkojnë pasuri, për të cilët kemi bërë fjalë dje. Ata vërtet donë të jenë të pasur. Por, kur befas i pyet sesa donë të fitojnë brenda vitit, shumica prej tyre nuk janë në gjendje të përgjigjen. Kur nuk di se ku shkon, më së shpeshti askund nuk mbërrin.”

Kjo ka pasur kuptim të përsosur për djaloshin e ri. Ka qenë absolutisht e thjeshtë. Po pse, o Zot, atij nuk i është kujtuar më herët? Ndoshta se kurrë më parë nuk është ndalur që të mendojë për këtë. Ky ka qenë gabimi. Deficit mendimi. Është betuar në atë moment se ka për të menduar më tepër në të ardhmen. Kjo ka për t’i parandaluar shumë gabime.

“Lumturia, natyrisht, është definuar në milona mënyra të ndryshme”, ka vazhduar Milioneri. “Për secilin prej nesh, madje edhe për ne të cilët kemi menduar për të,

nënkupton gjëra të ndryshme. Por, do të ta jap çelësin për lumturinë. Nuk është definicion dhe vlen për secilin. Me këtë çelës, ke për të ditur, pa kurrfarë dyshimi, në çdo çast të jetës tënde, se a je i lumtur. E posaçërisht, se a e punon atë që të bën të lumtur. Duhet të ta tërheq vëmendjen se ajo që do ta them mund të të befasojë, madje mund të të duket ngapak e pikëllueshme dhe morbide. Pyetu: “Nëse sonte duhet patjetër të vdes, a mundem në çastin e vdekjes që të them se i kam arritur të gjitha që i kam dëshiruar?”

Djaloshi i ka ngritur vetullat.

“Nuk po kuptoj”, ka pranuar.

“Nëse për çdo ditë e punon pikërisht atë që qenia jote e brendshme e ndien, nga dita në ditë ndihesh më i lirë që ta lëshosh këtë botë. Por, për të qenë i sigurt se e bën atë që do të duhej ta bëje, duhet ta punosh atë që dëshiron. Njerëzit që nuk e punojnë atë që dëshirojnë, nuk janë të lumtur. E kalojnë kohën e tyre duke ëndërruar për atë që do të dëshironin ta punoni, nuk janë të lumtur. Dhe duke qenë se, në të vërtetë, kurrë nuk e punojnë atë që dëshirojnë, pashmangshmërisht janë të palumtur. **E kur njerëzit nuk janë të lumtur, nuk janë të gatshëm të vdesin.**”

“Vetëm sa kam filluar të jetoj, e ju po më flisni për vdekjen, si të ishte ajo këtu, para hundës”, foli i trazuar djaloshi.

“Më duhet të pranoj se kjo filozofi në shikim të parë mund të duket si filozofi e vdekjes. Megjithatë, kjo qind për qind është filozofi e jetës. Ata që kurrë nuk e punojnë atë që në të vërtetë e donë, të cilët kanë hequr dorë nga ëndrrat

e veta, ata janë të ashtuquajturit të vdekurit e gjallë. Për ta kuptuar këtë filozofi, pyete veten përsëri dhe përgjigju plotësisht i sinqertë. Nëse gënjen, e gënjen vetveten dhe bëhesh humbës në këtë lojë. Po ta dije se nesër ke për të vdekur, a do t'i kishe ndërruar planet e tua për sot? A do të kishe jetuar tjetërndryshe nga sot?”

“Nuk jam plotësisht i sigurt, zotëri.”

“Sigurisht do t'ia filloje me përgatitjet e detyrueshme: do ta përpiloje testamentin, nëse këtë nuk e ke bërë më parë, do të ishe përshëndetur me familjen dhe miqtë. Por, ta zëmë se për ato punë rutimore të nevojitet vetëm një orë, çfarë do të kishe bërë me njëzet e tri orët tjera? Pyete për këtë secilin që njeh. Përgjigjet e tyre do të mund të futeshin në dy kategori. Njerëzit e palumtur, të cilët nuk kënaqen në jetën e tyre, do të thonin se do të punonin diçka krejt tjetër. Dhe nuk duhet t'i pyesësh se a e thonë të vërtetën. Pse, vallë, do të vazhdonin ta bënëin atë që e urrejnë, nëse iu mbeten vetëm edhe njëzet e katër orë jetë?”

“Kategoria e dytë”, ka vazhduar Milioneri, “e, fatkeqësisht, kjo është pakica, do ta punonin atë të njëjtën që zakonisht e punojnë çdo ditë. E pse ta ndërronin? Puna e tyre është pasioni i tyre. A nuk është krejt e kuptueshme se atë do të dëshironin ta bënëin gjer në vdekje? Pse do të fillonin të punonin diçka që nuk e donë? Bahu i ka takuar kësaj kategorie. Në shtratin e vdekjes e ka përmirësuar pjesën e fundit muzikore të cilën e kishte shkruar. Por nuk duhet të jesh gjeni për të dëshiruar të punosh gjer në

vdekje. Secili prej nesh, në mënyrën e vet, në profesionin e vet mund të bëhet gjeni, madje edhe kur shoqëria këtë nuk e sheh. Të bëhesh gjeni thjesht don të thotë ta punosh atë në të cilën kënaqesh. Kjo në jetë don të thotë të jesh gjeni i vërtetë. Mediokritetet kurrë nuk gjykojnë ta punojnë atë që duan – nga frika se çfarë do të thonë të tjerët, nga frika se mo po e humbasin sigurinë.”

“Sigurinë që më së shpeshti është iluzion, apo jo?” me drojë është kyçur djaloshi.

“Ke të drejtë, prandaj pyete veten: Nëse nesër më duhet të vdes, çfarë do të bëj me orët e fundit të jetës sime? A do të vazhdoj të jem vetëm hije e zbetë e vetvetes, plotësisht pa vetënderim, sepse detyrohem të punoj diçka që urrej? Paramendo ta ftosh mikun në shtëpinë tënde të të ndihmojë në përgatitjen e shtëpisë. A do t’ia jepje mikut punët më të ndyta? Sigurisht se jo. Pse atëherë vetvetes t’ia imponosh punët të cilat i quan si nënçmuese? Pse vetvetes t’i jesh armiku më i madh? Pse të mos i bëhesh vetvetes miku më i madh?”

Pas këtyre fjalëve ka sunduar qetësia.

Milioneri plak pastaj ka vazhduar:

“Dhe çfarë do të bëje ti tash, po qe se nesër do të duhej të vdisje? A do ta punoje pikërisht këtë që tash e bën?”

“Jo, nuk do ta kisha bërë”, iu desh të pranonte djaloshi.

“Kjo don të thotë se sigurisht nuk je i lumtur. E tash mendo për tjetrën. A nuk e merr si skajshmërisht paturpësi të besosh se nesër *nuk do të vdesësh?*”

Pas këtyre fjalëve, djaloshi është ndier i trazuar. Ditëve të fundit plaku ka treguar shpesh aftësi të jashtëzakonshme për parashikimin e ardhmërisë. A mos tash po e paralajmëronte vdekjen e tij të afërt? Ndoshta me rrotull, por mjaft qartë.

Milioni sikur t’ia lexonte mendimet. Trazimi i djaloshit ka qenë relativisht i dukshëm.

“Mos u brengos”, ka thënë i kënaqur, “nuk do të vdesësh nesër. Ke për ta pritur kohën e pjekurisë... por, më lejo t’i vazhdoj mendimet e mia. Ta marrim tash një rast përgjithësues. Ka për të prekur më pak sesa këto argumente morbide. Kur jetën e shikon me arsye, jeta merr tjetër kuptim. Por ende nuk kemi ardhur gjer tek ajo pikë, apo jo? A nuk po mendon se është jomodeste nga njerëzit kur sillen si ta kenë tërë jetën para vetes? Në shumicën e rasteve vdekja lajmërohet si vetëtimë në qiellin e kthjellët. Njerëzit, sakaq, besojnë në sigurinë – apo edhe më mirë: në iluzionin – se kanë shumë kohë para vetes, duke ia lejuar vetvetes që në pafundësi t’i shtojnë vendimet që do të duhej t’i sillnin sot. Ata thonë: “Kam kohë. Punoj më vonë.” Dhe vjen pleqëria e ata e kuptojnë se asgjë nuk kanë bërë.”

“Ndoshta për këtë shkak themi: “Sikur pleqëria të mund ta bënte atë që rinia nuk ka ditur”, ka thënë djaloshi.

“Kjo është, fatkeqësisht, e vërtetë. E fshehta e lumturisë, prandaj, është ta jetosh secilën ditë si të ishte e

fundit në jetën tënde. Dhe të jetosh për çdo ditë në plotni si duhet, dhe të punosh si ato ditë të ishin të numëruara. Se, në të vërtetë, ato edhe janë të numëruara. Por duket se për këtë bëhemi të vetëdijshëm vetëm kur të na ketë mbetur edhe pak kohë. E atëherë është së tepërmi vonë. Duhet prandaj të jesh mjaft i guximshëm dhe të veprosh menjëherë. Jeto me këtë mendim: “Refuzoj të vdes pa e pas punuar atë që dëshiroj. Nuk dëshiroj të vdes me atë mendim të tmerrshëm se shoqëria më ka mashtruar, se e ka fituar atë më të mirën prej meje e m’i ka asgjësuar ëndrrat e mia.” Nuk guxon të vdesësh me mendimin e tmerrshëm se frikësimet janë më të fuqishme se ëndrrat e tua dhe se kurrë nuk e ke zbuluar se ku në të vërtetë kënaqesh. Duhet të dish dhe ta gjykossh.”

“Pajtohem me idetë e tua. Mendoj se kanë shumë kuptim. Por çfarë ndodh kur nuk jam i sigurt se a e dua atë që punoj? Nuk di asnjë profesion pa probleme. Nëse çdo gjë do të ishte e përsosur, nuk do të ishim këtu.”

“Ke plotësisht të drejtë. Madje edhe profesioni që na inspiron i ka anët e veta negative. Edhe një mënyrë për ta zbuluar se a të kënaqë profesioni yt, është që ta pyesësh veten: “Po t’i kisha një milion funta në bankë, a do ta kisha vazhduar këtë punë?” Natyrisht, nëse përgjigjja jote është jo, atëherë në të vërtetë nuk e do punën tënde. Më thuaj se sa njerëz do të vazhdonin ta punoni punën e tyre nëse befasisht do të bëheshin milionerë? Është e vërtetë se pakkush do ta bënte. Përpos kësaj, ata që pozitivisht do të përgjigjeshin në këtë, veçse janë milionerë. Përndryshe, më



herët do të kishin shkuar në pension apo do të kishin punuar diçka tjetër. Por shumica e milionerëve që i njoh nuk donë të shkojnë në pension dhe punojnë gjer në pleqërinë e thellë. Do të kisha gjykuar madje të them se të gjithë milionerët, përpos atyre të cilët pasurinë e tyre e kanë arritur me fejesë apo me trashëgimi, janë bërë milionerë shkaku se e kanë dashur punën e tyre.”

“Të menduarit tim ka bërë rreth të plotë”, ka vazhduar. “Për t’u bërë milioner, apo së paku i pasur, duhet të kënaqesh në profesionin tënd. Ata të cilët e punojnë një punë e nuk e donë, janë dyfish të dënuar. Jo vetëm se i lodh puna e tyre, por edhe më keq, ajo nuk i pasuron. Në të vërtetë, shumica e njerëzve e jetojnë jetën në këtë paradoks të pazakonshëm. Pse? Sepse nuk i dinë ligjet e vërteta të suksesit. Edhe shkaku i frikës. I harxhojnë jetërat e tyre dhe shansat për t’u bërë vërtet të pasur duke u mbajtur fuqimisht për njëfarë lloj sigurie e cila, më së paku, është siguri gjysmake. Besojnë se pasuria u dedikohet disa të tjerëve apo se nuk kanë talent. Dhe për këtë lejojnë që ai iluzion t’i mashtrojë. Se mendja nuk është mjaft e fuqishme sa ta shohë realitetin, ta shikojë në sy atë iluzion. Mbaje në mend maksimumin: *“Karakterit don të thotë fat”*. Fuqizoje mendjen tënde dhe rrethanat kanë për të sjellë gjer tek realizimi i dëshirave të tua. Do ta kontrollosh jetën tënde.”

“Vallë, a keni qenë ju prej fillimit të lumtur?”

“T’ua them të drejtën, nuk kam qenë. Ka pasur momente kur kam qenë tepër i mjerë. Madje më ka shkuar ndër mend që edhe t’i jap fund jetës sime. Gjithnjë deri në

ditën kur edhe unë e kam takuar milionerin ekscentrik i cili ma pati mësuar këtë të cilën unë po e flas.

Në fillim kam qenë relativisht skeptik. Nuk kam besuar se kjo teori mund të zbatohet në rastin tim, edhe pse ai ka qenë argument i gjallë se sjell rezultate. Në fund, pasi i kam provuar shumë gjëra dhe akoma isha i pasuksesshëm, e meqë nuk kam pasur se çfarë të humbas, kam vendosur të provoj. I kam pasur tridhjetë vjet dhe e kam ndier se jeta po më kalonte kot. Më dukej sikur gjërat po më rrëshqisnin nga dora.”

“Jam i sigurt se sot nuk ankoheni që i keni pranuar këshillat e njeriut të vjetër ekscentrik.”

“Shpesh e ka përsëritur se mund ta zotëronte jetën e vet dhe t’i kontrollonte ngjarjet rreth vetes. Kurrë s’i kam besuar. I ka ngjarë fantastikës shkencore. E atëherë, një ditë, duke e dëgjuar sesi për çdo ditë e përsëriste tregimin e njëjtë, kam filluar të mendoj se ndoshta ka të drejtë, se jeta ndoshta nuk është ajo që gjithmonë e mendoj – vargua i ngjarjeve pak a shumë të paparashikueshme të cilat është e pamundur t’i kontrollosh e mbi të cilat dominojnë fati dhe fatkeqësia. E kam ndier se ndoshta mund ta kontrollojmë fatin tonë nëse e kontrollojmë mendjen tonë. E kam vënë re se kështu kam filluar të mendoj – me fjalë të tjera, e kam njohur se ka ardhur gjer tek revolucioni në kokën time – por vetëm shkak i asaj se kohë të caktuar e kam përsëritur formulën të cilën ma ka thënë: PËR CDO DITË, NË ÇDO ASPEKT, GJITHNJË E MË TEPËR PO PËRPAROJ.

Mentori im ma ka mësuar edhe një formulë, për të cilën mendoj se është edhe më e fuqishme – së paku sa i përket përvojës sime. Natyrisht se me krejt zemrën ta rekomandoj edhe ty. E vërtetë, është ngapak religjioze, që ndoshta disa njerëz do t’i iritojë. Kjo është dëm, duke pasur parasysh se ka ndikim të pakufishëm në mendje. Të përsëriturit e asaj formule më ka qetësuar kur kam qenë i trazuar apo i nervozuar dhe më ka dhënë përgjigje kur vërtet kam pasur nevojë. Qetësia është manifestimi më i madh i fuqisë. Shikoj të fortit dhe të fuqishmit: ata janë të qetë. Dhe çfarë është simbol i fuqisë më të madhe? Zoti, natyrisht. Kjo është një nga shkaqet që formula të cilën do të ta them është aq e suksesshme: **JI I QETË DHE DIJE SE UNË JAM ZOTI.**

Përsërite këtë formulë për çdo ditë sa më shpesh që mundesh. Ka për ta dhënë ndiesinë e kthjelltësisë, aq e nevojshme që të tejkalohen vështirësitë jetësore. Kur mentori im ka vendosur që të ma zbulojë këtë, ka thënë se prej gjithë fshehtësive në botë kjo është më e fuqishmja. Këtë ma ka lënë si trashëgimi shpirtërore, siç po ta lë unë ty. Vetëm në bazë të kësaj mund ta dish sesa është fuqia e kësaj formule.”

“Shpresoj se nuk do të fillosh të predikosh”, është përgjigjur djaloshi, “por e kam kuptuar porosinë tuaj.”

“Me përsëritjen e kësaj formule”, ka thënë plaku, “e cila në fillim m’u ka dukur e çuditshme, e kam zhvilluar një fuqi të brendshme të re. Ajo fuqi, e cila gjatë viteve gjithmonë rritet, pandërprerë më përkujton diçka që

milioni gjithnjë ma ka përsëritur: “Unë mundem çdo gjë, asgjë për mua nuk është e pamundur meqë e zotëroj fatin tim.” Kështu, pak nga pak, jam bindur se mund ta orientoj jetën time saktësisht atje ku dëshiroj. Kam vazhduar ta zbatoj formulën dhe ta bëj pikërisht atë që mentori prej meje e ka kërkuar. Do të dëshiroja që edhe ti ta bësh këtë të njëjtën.”

## KREU 13

### Djaloshi mëson t'i shprehë dëshirat e veta

“Veçse e ke bërë hapin e parë”, ka sqaruar Milioneri. “E ke shprehur në mënyrë kuantitative qëllimin tënd – ke përcaktuar shumën dhe afatin. E tash ta bëjmë hapin e dytë.

Merr një copë letër dhe shkruaj krejt çka dëshiron në jetë. Ëndrra jote duhet të jetë precize që të mund të realizohet. Kjo është ajo që unë në fillim e kam dëshiruar.

Qëllimet financiare në pesë vjetët e ardhshme:

- Shtëpi në vlerë prej 300.000 funtash
- Kampshtëpiza në vlerë prej 150.000 funtash
- Mercedesi i vjetër i riparuar i vlefshëm 20.000 funta
- Të jem pa borxhe personale
- 200.000 funta të gatshme
- 200.000 funta të investuar në aksione e letra të tjera me vlerë
- 300.000 funta të investuar në prona të patundshme, vlera e të cilave është rritur gjashtë herë në raport me çmimin në kohën e blerjes.

Qëllimet e mia jo-financiare kanë qenë:

- Pushim dyjavor, më së paku tri herë në vit, kurdo që dëshiroj
- Të jem vetë patron dhe të mos punoj më shumë se 30 orë në javë
- Miq të pasur dhe inteligjentë të cilëve iu intereson biznesi dhe arti
- Gruaja e dashur dhe sharmante dhe fëmijët e tejmrekullueshëm të cilët do të ma mundësojnë të bëj jetë të plotë familjare
- Shërbëtori dhe kuzhinieri që të na lirojnë nga obligimet e përditshme

Djaloshi ka mbetur i habitur me fotografinë të cilën Milioneri veçsa e përshkroi.

“Duket tepër mirë për të qenë e vërtetë, apo jo?”, ka pyetur Milioneri. “Edhe unë atëbotë kam menduar se e kam tepruar ca kur kam shënuar krejt çfarë kam dëshiruar. Por lëkundjet e mia dhe frika kanë qenë ekskluzivisht rezultat i pikëpamjes sime mentale negative dhe i shprehive të rrënjosura të të menduarit për pak. E kam bërë këtë, e për këtë nuk kam qenë fare i vetëdijshëm.”

“Por”, ka vazhduar, “evidentimi i këtillë është mënyrë që saktësisht të zbulohet vizioni yt. Ata të cilët mendojnë se një plan jetësor i këtillë nuk është e mundur të realizohet, thjesht mendojnë shpirtvogëlsisht, sepse, duke e pasur parasysh se në këtë botë krejt është relative, një ambicie e tillë nuk është e tepruar. Argument është ky se të pasurit do të ishin tejet të palumtur po të ishin të detyruar të

jetonin në kushtet mizore të cilat sapo i përshkrova. Shumë prej tyre jetojnë nëpër shtëpi që vlejnë miliona, punësojnë shërbëtorë të shumtë, kanë avionët e tyre dhe ujdhesa në detet e jugut, kuaj garues e të ngjashme. A mendojnë ata se qëllimin jetësor e kanë përmbi të gjitha kriteret? Vështirë. Ata mandej as nuk mendojnë se janë të pasur. Gjithsesi jo shumë të pasur, sepse gjithnjë kanë miq e partnerë afaristë që kanë më shumë sesa ata. Pse ata mënyrën e tillë të jetesës e shohin të rëndomtë? Ose kanë lindur të pasur ose kanë menduar për shumë dhe e kanë mbërritur atë status, duke i realizuar ëndrrat e tyre. Asnjëri prej tyre kurrë nuk ka menduar se nuk ka për të pasur sukses. Nëse nisësh me idenë se nuk mundesh, veçse je bllokuar. Prandaj bëje këtë ushtrim. Përshkruaji deri në detajet e fundit ato që i dëshiron nga jeta dhe mos le asgjë anash.

Kjo ka për t'i treguar kufijtë e ambicies tënde si dhe kufizimet mentale. Për çfarë në të vërtetë ëndërron? Me çfarë do të ishe i kënaqur? Me rëndësi është të përshkruhen sa më shumë detaje. Të vetmes që duhet ikur është që të mos e zgjedhësh shtëpinë e ëndrruar në adresën saktësisht të përcaktuar, sepse mu ajo shtëpi ndoshta kurrë nuk do të jetë në dispozicion. I hyn rrezikut që ëndrra jote kurrë të mos realizohet përkundër forcës së dëshirës dhe vullnetit tënd apo ndoshta pse është kundër rendit natyror të gjërave apo e dëmshme për të tjerët – diçka gjithmonë duhet të merret parasysh.

Kjo fotografi do të tregojë se kush je ti në të vërtetë. E fiton trajtën konkrete të dëshirave të tua. Mendimet e tua

janë modele. Ato janë të gjalla. Çdo mendim i shprehur synon të realizohet. Sa më i përcaktuar që të jetë, aq më të mëdha janë gjasat që të realizohet. Prandaj janë të rëndësishme detajet. Në mënyrë misterioze dhe të papritur ato mendime, në qoftë se shpesh pohohen, të sjellin gjer tek rrethanat në të cilat do të realizohen.”

Pasi që djaloshi krejt këtë e ka dëgjuar me skepsë, Milioneri ka shtuar:

“E di se krejt kjo duket si utopi. Por, siç thashë, sa më shumë mendja jote fuqizohet, aq më parë ke për ta kuptuar se nuk ekziston asgjë që nuk mund ta arrish. Përpos kësaj, vetëm mendo se ç’forcë ka pasur Jezu Krishti për të bërë çudira siç ka qenë ringjallja e të vdekurit. A nuk mendon, vallë, se në krahasim me këtë, ta kesh pronë tënden shtëpinë prej 300.000 funtash, në të vërtetë është arritje banale? A s’po mendon, vallë, se mendja është shumë më e fuqishme sesa që njerëzit e zakonshëm e mendojnë apo sesa besojnë të jetë. Mendo se çfarë Krishti ka thënë: “Besimi lëviz malet”

Djaloshi ka heshtur i menduar.

“Që ta shfrytëzosh me sukses mendjen, duhet të besosh në forcën e saj. Gjithsesi duhet të jesh pozitivisht i prirur. Duhet t’ia japësh shansën. Prandaj bëje evidentimin. A e sheh, vallë, që tani se ky është hapi i parë dhe akoma i arritshëm në krahasim me të ringjallurit? A nuk e ke kuptuar, vallë, deri tash se mund t’i arrish këto gjëra aq të thjeshta në jetën tënde?

“Më duhet të mendoj”, ka rezistuar djaloshi.



“Ide e mirë. Mendo për këtë që pikërisht ta kam thënë. Një pjesë në ty po iu beson fjalëve të mia. Pjesa tjetër është e verbuar dhe e katandisur shkaku i arsimimit afatgjatë të gabuar dhe të përvojave të këqija – por akoma është gjallë dhe vetëm pret shenjën tënde për t’u zgjuar. Dhe, të bëhesh zotërues dhe sundues i ekzistencës tënde në vend se të jesh rob i maltretuar i cili padobishëm lufton me ngjarjet. Dëgjoje atë zë të dobët të brendshëm i cili fle në thellësinë e mendjes tënde dhe jepi më shumë liri të vijë në shprehje. Sa më shpesh e përsërit atë formulë, ka për t’u bërë aq më e fuqishme dhe më sigurt ka për të udhëhequr. Ajo është intuita jote, zëri i zemrës sate. Rruga gjer te fuqia jote e qëndrueshme.”

Djaloshi ka qenë paksa i trullosur dhe i gatshëm për t’u kotur.

“Eja”, i ka thënë Milioneri, “të shëtisim kopshtit e të shlodhemi. Do të dëshiroja të shëtitesha këtej për të fundit herë në shoqëri me mikun.”

Ato fjalë të zymta e kanë pikëlluar djaloshin. Nuk ka qenë hera e parë që Milioneri të ketë bërë aso aluzioni... si ta dinte se vdekjen e kishte afër.

## KREU 14

### **Djaloshi zbulon fshehtësitë e kopshtit me trëndafila**

Dy njerëz kanë shëtitur kopshtit. Milioneri është ndalur pranë degës së trëndafilit përplot gonxhe të bukura dhe është dukur si i thelluar në mendime. E pastaj është drejtuar dhe ka thënë:

“Këtyre gonxheve duhet që t’iu kam marrë erë mijëra herë dhe akoma, secilën herë, ndryshe i përjetoj. A di pse? Sepse kam mësuar të jetoj *TASH* dhe *KËTU*. Nuk mendoj për të kaluarën, nuk çaj kokë për të ardhmen. Fshehtësia është jashtëzakonisht e thjeshtë. Gjendet në koncentrimin mental. Sa më e koncentruar të jetë mendja, aq më shumë jeton në momentin e tanishëm, më shumë e preokupuar me atë që punon. Koncentrimi është vendimtar për sukses në të gjitha fushat e jetës. Sa më mirë që të mund të koncentrohesh, aq më shpejt dhe aq më suksesshëm ke për të punuar. Do t’i vësh detajet të cilat të tjerët i kanë anashkaluar.”

“A thua, vallë, të gjithë njerëzit e pasur të suksesshëm kanë mësuar t’u japin rëndësi detajeve?”

“Vërtet po. Me rritjen e forcës së koncentrimin urtësisht mund t’i vështrosh gjërat. Mëson që njerëzit që takon t’i vlerësosh në mënyrë adekuate. Forca e koncentrimin ta mundëson që menjëherë të vësh sesi janë

në të vërtetë. Dhe bëhesh objektiv në kuptimin e vërtetë të fjalës. Apo, thënë më mirë – në kuptimin më të thellë. I sheh gjërat ashtu siç janë. Mendimet e mjegulluara dhe ëndërrimet që i hasim tek shumica e njerëzve, nuk kanë për të qenë më pengesë për vështrimin tënd të gjërave. Gjithnjë të hutuatr, shumica e njerëzve somnambulojnë nëpër jetë. Ata nuk i shohin gjërat as njerëzit që i takojnë. Jetojnë si në ëndërr. Kurrë nuk janë në momentin e tanishëm. Prandaj, ata kurrë nuk janë këtu. I përcjellin gabimet dhe mosukseset. Mendja e tyre është përplot frikë për të ardhmen.

“Siç po më duket, koncentrimi del hallka më e lehtë në teorinë tuaj.”

“Shih, djalosh. Nuk sukseson secili që ia fillon. Por kur mendja arrin nivelin e caktuar të koncentrimin, aftësia jote e zgjidhjes së problemeve bëhet e jashtëzakonshme. Do të bëhesh objektiv... Në vend se ta harxhosh energjinë duke kafshuar thonjtë prej brengave, koncentrohesh në zgjidhjen e problemeve. Mos harro se shqetësimi i madh dhe brengosja nuk kanë zgjidhur kurrë kurrëgjë. Vetëm sa kanë qenë shkaktarë për të thatin në lukth dhe sulmet në zemër. *Imixhi* yt personal ka për të ndryshuar. Secila krijesë njerëzore është enigmë. Problemi është se çdonjëri nga ne është fshehtësi, jo vetëm për të tjerët, por edhe për vetveten. Kjo është për shkak të mungesës së koncentrimin.”

Djaloshi e ka thithur secilën fjalë të plakut. Dhe duke mos dashur që të lë t'i rrjedhë çfarëdoqoftë, nuk ka gjykuar që ta ndërpresë.

“Duke iu falënderuar koncentrimin”, ka vazhduar Milioneri, “ke për të kuptuar se pse në këtë botë ndodhesh pikërisht në vendin ku tash je. Ke për ta pasur gjithnjë e më të qartë e më të qartë dhe ajo për ty do të jetë gjë e thjeshtë. Në mendjen tënde ka për të depërtuar mendimi shumë qetësues dhe kurajues i cili do të të bëjë që të brohorisësh si pas gjumit të gjatë e të thellë: “Po, ky qenkam unë! Për këtë shkak jam këtu, në këtë moment! Prandaj e punoj këtë që e punoj! Prandaj jam këtu me personin e caktuar!” Do të mund ta ndjesh atë që quhet “dora e fatit”. Do ta kuptosh fatin tënd. Dhe ndjenja e pranimit do të depërtojë në mendjen tënde. Kjo nuk do të thotë se duhet t'i dorëzohesh fatit tënd. Jo, duke patur parasysh se do ta konstatosh pozitën tënde në atë moment, ke për ta pranuar deri në kufijtë e caktuar – ke për ta njohur pikën fillestare personale e cila ka për të ndihmuar dhe udhëhequr në jetën e ardhshme, për të mundur fuqimisht ta marrësh fatin në dorën tënde.”

Milioneri ka pushuar të flasë për t'u gërmucur dhe për t'i marrë përsëri erë trëndafilin, të cilit i pati marrë erë që më parë.

“Trëndafili prejgjithmonë ka qenë simbol i jetës. Nëse arrin ta kontrollosh mendjen tënde, do ta kuptosh pse. Gjembja paraqet rrugën gjer te përvoja: të gjithë duhet t'i

provojmë tundimet dhe vuajtjet për ta kuptuar bukurinë e ekzistencës.”

Kur këtë e ka thënë, i ka nxjerrë nga xhepi gërshërët e kopshtarit, e ka këputur me to trëndafilin dhe ia ka ofruar përcjellësit të vet të ri.

“Ruaje këtë trëndafil tërë jetën”, ka thënë. “Ka për të vepruar si talisman duke të sjellë fat. Zonjushëza lumturi ekziston vërtet, edhe pse pak njerëz dinë për të. Beso në të! Ledhatoje me mendimet e tua. Kërko prej saj atë që dëshiron. Do të përgjigjet. Të gjithë njerëzit e suksesshëm beojnë në lumturinë, përkundër asaj se shumë të tjerë ata i marrin si bestytë. Por, dije: ata kanë të drejtë.

Me këtë trëndafil të thjeshtë dije se je bërë anëtar i *rendit të trëndafilave*. Çdoherë kur ta ndiesh nevojën, gjeje përsëri këtë trëndafil. Ka për të të dhënë fuqi. Çdoherë kur të dyshosh në vetvete, çdoherë kur jeta të bëhet e padurueshme, ktheju këtij trëndafili simbolik dhe përkujto se çfarë paraqet ai. Çdo tundim, çdo problem, çdo gabim një ditë ka për t’u shndërruar në petale të tejmrekullueshme. Ngjashëm me këtë trung plot gjemba, vuajtja çon kah drita dhe do të të bëjë ta arrish bukurinë. Për çdo ditë ndaj pak kohë dhe koncentrohu në zemrën e trëndafilit. Nëse nuk e ke pranë vetes trëndafilin, merre cilëndo lule apo koncentrohu në një pikë të zezë apo në ndonjë gjë të shndritshme. Mund ta përsërisësh qetësisht formulën të cilën mentori im ma pati lënë: PËR KËTË JI I QETË DHE DIJE SE UNË JAM ZOT I BOTËS. Kundroje lulen apo pikën e zezë gjithnjë e më gjatë e më gjatë. Pas

njëzet minutash, koncentrimi yt do të jetë i shkëlqyeshëm. Nëse zemra jote bëhet sikur ky trëndafil, jeta jote ka për të ndryshuar.”

Djaloshi memzi e ka thithur aromën dehëse të trëndafilit kur plaku ka vazhduar:

“Më lejo ta përsëris atë që kam thënë. E fshehta është në koncentrimin mental. Kur mendja përmes ushtrimeve të koncentrimit fuqizohet dhe e arrin vetëbesimin, ke për ta kuptuar se problemet jetësore më nuk të udhëheqin ty. Atëherë do ta kuptosh këtë që do ta them, e cila ndoshta vetvetiu të duket e qartë dhe mjaft banale. Gjërat janë të rëndësishme vetëm aq sa mendja jonë beson se janë të rëndësishme. Problemi është problem vetëm nëse ti atë e sheh si të tillë.”

“Ç’do të thotë kjo?” ka vazhduar. Nëse mendon se asgjë nuk është serioze, se asgjë vërtet nuk është e rëndësishme, atëherë në sytë e tu *asgjë nuk ka për të qenë serioze, e as që diçka do të jetë e rëndësishme*. Problemet kanë për t’u dukur të mëdha dhe të pazgjidhshme, në proporcion me dobësitë e mendjes tënde. Sa më e fuqishme që do të jetë mendja, për aq problemet do të duken të parëndësishme. Kjo është e fshehta e paqes së përjetshme. Prandaj, *koncentrohu!* Ky është një nga çelësat më të rëndësishëm të suksesit.

Në të vërtetë, e tërë jeta në esencë është ushtrim i gjatë koncentrimi. Shpirti është i pavdekshëm. Duke kaluar nga jeta në jetë, mendja ngadalë e gjen vetveten dhe zhvillohet. Ky shëgjtim rëndom është afatgjatë. Njerëzit

rrallë përjetojnë suksese, se vetëm ata me shkallë të lartë koncentrimi i realizojnë qëllimet e tyre. Natyrisht, jo të gjithë të suksesshmit e kanë quajtur të rëndësishëm ushtrimin e koncentrimin. Por gjatë kohës së jetërave të suksesshme të tyre në tokë, kanë arritur shkallë koncentrimi i cili i ka sjellë më lehtë gjer te suksesi sesa të tjerët. Kur mendja arrin nivelin më të lartë të koncentrimin, ke për të hyrë në një gjendje të veçantë në të cilën ëndrrat dhe realiteti hëpërhë pikëtakohen.”

Milioneri dhe djaloshi janë kthyer në shtëpi. Qielli befas është nxier dhe e kanë mbuluar retë. Kurse në mëngjes pati shkëlqyer dielli. Stuhia ka qenë në horizont dhe shtëpia tash ka qenë aq e errët saqë ka qenë dashur t’i ndezin qirinjtë. Plaku në shandan ka ndezur shtatë qirinj, sigurisht vetëm për hir të mbresës romantike, së cilës djaloshi nuk gjykoi t’i kundërvihet. Pastaj është ndalur përskaj dritares në të cilën perdja është lëkundur nga era. E ka shpalosur dhe e ka shikuar qiellin. Atëherë i është drejtuar djaloshit me këto fjalë:

“Gjithmonë mendo se në lartësitë e caktuara kurrë nuk ka re. Nëse retë në jetën tënde ta zënë diellin, kjo është për atë se shpirti yt nuk është ngritur në lartësinë e duhur. Shumica e njerëzve bën gabim duke u kacafytur me problemet. Pothuajse fuqimisht kanë vendosur t’i largojnë retë, t’i shpërndajnë me ndonjë veprim magjik. Natyrisht se do të mund t’i mënjanojnë përkohësisht, porse retë përherë do të kthehen dhe do të vendosen në mes tyre dhe Diellit, duke ua zënë dritën sado që ajo të jetë e fortë. Ajo çfarë

duhet bërë është të ngrihesh përmbi retë, njëherë e përgjithmonë. Kundroje zemrën e trëndafilin gjithnjë e më gjatë e më gjatë. Aty ke për ta gjetur rrugën e cila ka për të dërguar përmbi re, atje ku qielli është përherë i kaltër. Mos e harxho kohën duke ndjekur retë, të cilat gjithmonë rishtas shfaqen...”

“Ndoshta nuk po kupton krejt çfarë tash po të them”, e ka përfunduar, “por pranoje këtë me besim të mirë.”

Milioni dhe djaloshi janë ulur pranë tavolinës për të darkuar. Shërbëtori është ofruar duke sjellë bukë e verë dhe duke iu shërbyer.

“Por, kohë të gjatë diçka po më intereson”, ka thënë djaloshi. Në të vërtetë kjo çështje e ka munduar që prej djehi. “Vërtet mendoj se keni të drejtë për të gjitha që keni folur. Dhe tashi besoj se, nëse zbatoj formulën që ma keni dhënë, mund të bëhem së frikti milioner dhe ta arrij paqen e shpirtit. Problem i vetëm imi është sesi ta vërtetoj se cila është ajo fushë ku mund ta realizoj pasurimin.”

Milioni ka qeshur. Kjo pyetje serioze dukshëm e ka argëtuar.

“Duhet të besosh në jetë dhe në fuqinë e mendjes tënde”, ka thënë. “Mos u brengos. Së pari vëre qëllimin, e atëherë kërko prej ndërdijes tënde më të thellë të të dërgojë shtegut gjer te pasuria. Fillo me pyetjet, pastaj prit. Nuk ka për të kaluar shumë kohë dhe përgjigja ka për të arritur.”



Djaloshi është dukur skeptik, e madje edhe i zhgënjyer me përgjigjen e Milionerit. S'ka dyshim se ka dëshiruar përgjigje paksa më konkrete.

Milioneri i cili pa dyshim fshehtësisht i ka lexuar mendimet, është trembur dhe dashamirësisht ka shtuar: “Së pari duhet të gjesh punë, e cila e kënaq zemrën tënde. Atëherë mendo për këtë. Të gjitha elementet e ftesës e cila do të të bënte të kënaqur, veçse janë në ty. Vetëm se këtë s'e kupton pasi që nuk je në harmoni me natyrën tënde të vërtetë. Me koncentrim të fuqishëm ke për t'u bërë gjithnjë e më i vetëdijshëm dhe përgjigjet vetvetiu kanë për të rrjedhur. Edhe për më tepër, ke për të zbuluar se shumica e njerëzve tërë jetën kërkojnë me dëshpërim dhe kurrë s'gjejnë asgjë, duke ndier shkaku i kësaj se jeta është absurde. Ke për të zbuluar qëllimin misterioz të ekzistencës tënde në botë. Ke për ta kuptuar atë jo vetëm me kuptimin tënd, por edhe me zemrën tënde. A sheh, vallë, se çdo gjë mund të arrish duke qenë i koncentruar në zemrën e trëndafilin? Aty është fillimi dhe fundi i tërë ekzistencës. Këtë me kohë ke për ta zbuluar.”

Është ndalur për një çast dhe ka pirë gllënkën e vogël me verë. Nuk është dukur sikur të pinte, por sikur vetëm po e provonte me kënaqësi. I ka mbyllur sytë në një lloj inspirimi religjioz.

“Po prej nga paratë për fillim?” ka pyetur djaloshi.  
“Nuk kam asnjë.”

“Sa të duhen?”

“Nuk di – së paku 10.000 funta. Kaq edhe juve ju janë dashur për fillim.”

“Sigurisht ekziston mënyra për t’i gjetur. Shiko pakëz. Sipas mendimit tënd, cilat rrugë i ke të hapura?”

“Sigurisht, nuk shoh asnjë. Nuk di asnjë bankë e cila do të më jepte kredi. Nuk kam garanci. Pak më mbetet nga rroga ime në fund të muajit, asgjë nuk kam, kurrfarë patundshmërie – madje as automobil!”

“Por, së paku a ke provuar, vallë?”

“Jo, por i sigurt jam se...”

“Ky është gabimi të cilin më kurrë nuk guxon ta përsërisësh. Mos u bëj si shumica të cilët heqin dorë ende pa provuar. Kjo është rruga më e mirë për të mos bërë asgjë dhe kurrë të mos kemi sukses. Mos bjerë në kurthin e njëjtë si ata të cilët diçka ndërmarrin, që më parë të bindur se nuk do të kenë sukses. Ata veçse ia fillojnë si humbës. Le të jenë mendimet e tua në harmoni me veprimin tënd. Ji në harmoni me vetveten.”

“Në rregull, i gatshëm jam, por problemi im akoma nuk është i zgjidhur. Mund të provoj gjithnjë...”

“Duhet t’ia fillosh me bindjen e fortë se zgjidhja ekziston – zgjidhja ideale e problemit tënd. Me fuqinë e mendjes dhe me magjinë e qëllimit tënd pashmangshëm ke për ta tërhequr zgjidhjen në mënyrën në të cilën madje as nuk di se ekziston. Ji në vetvete i bindur se do të kesh sukses dhe ke për të pasur. Mos i le vend dyshimit. Përzëre me fuqinë e mendjes tënde në dispozicion. Dyshimi është pjesë e fuqisë së errësirës, derisa optimizmi që ke i takon

mbretërisë së dritës dhe jetës. Këto dy forca janë në konflikt të përhershëm. Lufta pandërprerë kundër dyshimit. Sepse edhe dyshimi është mendim, ndaj, si edhe të gjitha mendimet tjera, synon të materializohet në jetën tënde. Në qoftë se fuqimisht je i bindur se ke për të marrë kredi, ke për të marrë... A je i bindur se ke për ta fituar?”

“Po. Tash jam. Më keni bindur.”

“Në rrethanat e tua të tanishme, çfarë do të kishe bërë për ta arritur qëllimin tënd – pra, për të marrë kredi?”

“Në të vërtetë, nuk di.”

“Sikur ta kesh në dispozicion vetëm një kohë të shkurtër – ta zëmë një orë – për t’i marrë 10.000 funta dhe për t’u nisur në punën tënde, çfarë do të kishe bërë?”

“Akoma s’kam ide...”

“Para teje është milioneri i cili pikërisht po të jep kurajo, i cili ta ka zbuluar sekretin e suksesit të vet, kurse ti nuk di se çfarë do të bësh?! A nuk po të bie vallë ndër mend qoftë edhe një mënyrë e vetme, me anë të së cilës do të mund t’i fitoje paratë?”

Përfundimisht djaloshit i ka shkrepur se çfarë po aludonte Milioneri. Ndoshta vetëm ka qenë dashur t’i kërkoj të hollat. Duke u lëkundur për një kohë, ka vendosur.

“A do të kishit mundur të m’i huazonit 10.000 funta për të cilat kam nevojë?”

“Përfundimisht! Vallë a nuk ishte e lehtë? Vetëm ka qenë dashur të pyesësh. Por, njerëzit nuk kanë guxim as të pyesin. *Duhet të kesh guxim të pyesësh.*”

Plaku atëherë i ka nxjerrë 10.000 funta të cilët gjithnjë i ka pasur me vete që kur djaloshi ka mbërritur e të cilët sigurisht i kishte si para xhepi – sasi mahnitëse në sytë e vdekëtarit të rëndomtë, por për të fare të parëndësishme. Gjithsesi, për të ato para nuk kanë pasur qëllim, duke qenë se ka jetuar i izoluar nga bota e jashtme.

Duke hedhur një shikim nostalgjik në dengun e të hollave në dorë – shikim i cili nuk ka mundur t'i përshkruhet asaj se po i jepte – Milioneri ia ka ofruar djaloshit. Djaloshi i hutuar i ka marrë. Kurrë në jetën e vet nuk ka pasur një shumë të tillë të hollash.

“Sigurisht mendon se qe e lehtë t'i fitosh këto para”, ka thënë plaku, “por po të them se nuk ka asnjë arsye që edhe në të ardhmen të mos fitosh para po kështu në mënyrë të lehtë. Për fat të keq, dominon bindja se është vështirë të vihet gjer te paratë dhe se duhet të punohet shumë për të fituar. Në të vërtetë, vlera e vetme e punës është në fuqizimin e forcës së mendjes dhe në përpjekjen që ajo të mendojë më shumë. Kur të fitosh shumë të holla – e unë të garantoj se për atë nuk do të duhet shumë kohë nëse i zbaton të fshehtat të cilat t'i kam mësuar – do ta kuptosh se është me rëndësi qëndrimi yt mental, fuqia e dëshirave të tua dhe fakti se mund ta orientosh kah qëllimet e caktuara financiare. Shumica e njerëzve nuk suksesojnë sepse nuk bëjnë kështu. Pikërisht për këtë janë të shtrënguar të punojnë shumë apo, ta bëjnë punën që nuk e donë, për të fituar për jetë. Mos harro se rrethanat e jashtme gjithmonë e

shprehin gjendjen e mendjes tënde dhe natyrën e bindjeve të tua më të thella.”

Tejet i hareshëm dhe me 10.000 funta para vetes, djaloshti i ka dëgjuar vetëm me një gjysmë veshi këshillat e urta të Milionerit.

“Prandaj, kur të duhen para, djalosh, mbaje këtë në mend: nëse je i sigurt se lehtë dhe shpejt ke për t’i fituar paratë, ashtu do t’i fitosh. Por, posa që dyshimi të futet në mendjen tënde, përkujto këto 10.000 funta të cilët pikërisht i fitove. Krejt çka është e nevojshme është se duhet të pyesësh. Nëse je i bindur se ke për ta fituar atë që e kërkon në çdo çast kur e kërkon, nëse sillesh si vërtet t’i kishe ato, atëherë ato edhe do t’i fitosh. Mbaje në mend, bindjet tona më të thella gjithnjë realizohen.”

“E çfarë ka për të ndodhur nëse më kaplon dyshimi?”

“Nëse deri tek ajo vjen, mënyra më e mirë të lirohesh prej tyre është ta zbatosh autosugjestionin dhe ta përsërisësh të kundërtën. Shndërroji fjalët e tua në dekret mbretëror. Kur mendja jote të bëhet mjaft e fuqishme, çdo fjalë bëhet dispozitë. Fjalët e tua dhe realiteti do të jenë një. Dhe koha e cila është e nevojshme që dispozitat të realizohen do të jetë gjithnjë e më e shkurtër e më e shkurtër dhe, përfundimisht, do të jetë ajo vetëm një çast. Deri atëherë vërtet ke për të mësuar ta zotërosh vetveten. Duhet të jesh zot i mendimeve të tua për t’iu ikur mendimeve të cilat mund t’i dëmtojnë të tjerat. Duhet ta arrish aftësinë që të mendosh vetëm pozitivisht për

mirëqenien e të tjerëve, ashtu që fuqia e fjalëve të tua të mos kthehet kundër teje.”

Përsëri e ka bërë një pauzë të vogël.

“Këto të holla...”, ka vazhduar duke treguar në dengun e të hollave, “unë nuk po t’i huazoj...”

Është dukur sikur po lëkundej në sekondë, pa dyshim me shkathtësi duke planifikuar që me anë të trikut të ndikojë në djaloshin, për t’ia vlerësuar reaksionet e tij.

“Unë nuk po t’i huazoj paratë... po t’i jap”, ka thënë Milioneri. “Duke e bërë këtë, po e mbyll rrethin e plotë. Këto para janë të ndershme dhe të pastra, m’i ka dhënë mentori im që të mund t’ia filloja punës. As ti mos i përdor për kurrfarë qëllimi tjetër. Mos bëj si njeriu nga Bibla i cili i ka futur në dhe paratë e veta në vend se “t’i qarkullonte”. Aq shumë njerëz këtë e bëjnë. Ata e bëjnë gabimin më të madh të mundshëm. Lejojnë që t’i kaplojë frika. Frika është armiku yt më i madhi, vëllai i dyshimit, dhe duhet ta mposhtësh gjithsesi. Ji i pafrikësueshëm dhe i guximshëm. Secili që thirret në racionalitet dhe i fut në dhe paratë që i fiton, nuk i meriton. Nuk meriton më shumë dhe është pak e besueshme se ka për të fituar të tjera. Ai nuk e respekton njërin nga ligjet më të rëndësishme të jetës – ligjin e pasurisë. Paraja duhet të qarkullojë lirisht që të mund të rritet shumëfish.”

Djaloshi është kënaqur duke shikuar paratë e tij njësoj si edhe duke dëgjuar fjalët fisnike të mbrojtësit të vet.

“Paratë që po t’i jap, në të vërtetë, janë huazim”, ka vazhduar Milioneri. “Një ditë ti këto do t’i kthesh duke ia dhënë ndokujt. Nëpër shumë vite do ta takosh njeriun e ri në të njëjtën situatë në ë cilën je ti tash. Ke për ta njohur për nga shenja - ka për të bartur trëndafil. Duhet t’ia japësh të hollat të cilat unë sot t’i dhashë ty. Përpiqu që kjo atëherë le të jetë një sasi e parëndësishme për ty: para të imëta xhepi dhe asgjë më tepër. Të lutem të bësh siç bëra edhe unë – duhet t’ia japësh shumën e caktuar në vlerën e sotshme. Atëherë edhe ai mund të fillojë me një shumë të konsiderueshme, sepse shkaku i inflacionit 10.000 funta atëherë ndoshta nuk do të vlejnjë gjithaq.”

Djaloshi e ka miratuar duke luajtur kokën

“Kur i riu prej teje do t’i marrë të hollat, duhet solemnisht të betohet se ka për ta përhapur mësimin të cilin unë sot ta kam dhënë ty e të cilin ti ke për t’ia transmetuar. Mos e këput këtë vargua me kurrfarë kushtesh, se në të kundërtën nuk do të jesh i lumtur. E di se je njeri i ndershëm: për këtë shkak edhe nuk kam frikë të ta besoj këtë të fshehtë.”

Përplot nderim, djaloshi ngrohtësisht i është falënderuar.

“Ka edhe një gjë shumë të rëndësishme të cilën duhet ta dish...”

Pikërisht tash ka filluar stuhia. Milioneri në çast është ndalur dhe shprehja e fytyrës i është bërë e hidhëruar. Ka filluar shiu. “Të gjitha shenjat janë kalimtare” – ka mërmëritur për vete.

“Siç thashë”, i është drejtuar përsëri djaloshit, “ka një gjë të cilën duhet ta dish – e fshehta më e madhe të cilën do ta zbuloj e me të cilën mund të arrihen të gjitha qëllimet e dëshiruara. Thënë singërisht, arsyeja që kam mbledhur pasuri kaq të madhe nuk është në atë se paraja aq shumë më ka interesuar. Në esencë, kjo ka qenë vetëm rrugë që t’iu tregoj njerëzve se çfarë don të thotë fuqia e mendjes.”

Përsëri është ndalur pak, por djaloshi nuk ka gjykuar që ta pyeste çfarëdoqoftë. Pastaj ka vazhduar: “Vlera më e madhe e njeriut është liria e tij. Pasuria jep liri. Edhe për ty do të jetë mirë ta njohësh atë liri. Atëherë ke për të parë sesi shumë iluzione zhduken. Atëherë ke për ta kuptuar se liria e vërtetë është në pavarësinë, që është trajta më e lartë e lirisë. Vetëm ai që shkon me duart e zbrazëta, mund t’iu përkushtohet trëndafilave të përjetshëm. Arritja e kësaj lirie ka qenë qëllimi i fshehtë i tërë ekzistencës sime. Përkundër asaj se çfarë të tjerët mendojnë – sepse njerëzit vlerësojnë sipas shenjave të jashtme dhe më shohin vetëm si biznesmen të madh – kurrë nuk kam qenë asgjë më shumë se një kopshtar i përunjur.”

Djaloshi tash e pyeti:

“Pse po m’i thoni të gjitha këto? Pse m’i keni dhënë këto të holla? Asgjë *nuk* më keni borxh... Në të vërtetë, ka mundur të vijë dikush tjetër në vendin tim...”

“Por pikërisht është kështu. Askush tjetër nuk ka ardhur. Dëshira jote të ka sjellë tek unë. Kështu ngjarjet ndodhin në tëra rrethanat jetësore. A nuk thuhet vallë se,



njëherë kur nxënësi të jetë gati, mësuesi vetë ka për t'u lajmëruar? Përpos kësaj, unë kam fituar shumë. Është normale për mua të jap.”

“Ndoshta”, ka thënë djaloshi duke mos dëshiruar që ta lëshonin temën, “po pse bash unë, e jo dikush tjetër?”

Milioni ka qeshur. “Këmbëngulës je. Kjo më pëlqen.”

Është tretur shikimi i tij serioz e i largët dhe për të parën herë Milioni e ka shikuar djaloshin ngratësisht, pothuajse si prind.

“Nëse e do arsyen e vërtetë, do të ta them. Nuk di se a do të jesh sot i gatshëm ta pranosh. Por një ditë ndoshta do të mundesh...”

Shpirti është i përjetshëm. Dhe secili shpirt udhëton nga njëra në jetën tjetër, i rrethuar me shpirtërat e ngjashëm. Dhe secili shpirt i ndihmon tjetrit ta përmbushë fatin e vet. Takimet në jetën tonë kurrë nuk janë të rastit. Dhe rrallëherë e takojmë dikë për të parën herë. Ti ke qenë babai im në jetën e mëparme. A nuk është vallë e drejtë të më bëhesh biri im shpirtëror në këtë jetë?”

Djaloshi ka qenë i pushtuar nga ndjenja të thella, ashtu që nuk ka qenë krejtësisht i sigurt në e ka kuptuar atë që Milioni ka thënë, apo jo. Milioni i është afruar. Kurrë deri në këtë çast djaloshi nuk e ka ndier se kishte qëndrim mbretëror. Përkundër pleqërisë së tij të thellë, ka ecur si mbret, befasisht i lartë dhe i drejtë. Fytyrën e tij të gjallë pothuajse nuk e kanë prekur vitet. Me gishtin e tij

tregues të djathtë Milioneri e ka prekur ngadalë ballin e djaloshit dhe ka thënë:

“Zbuloje cili je, në të vërtetë. E vërteta përgjithmonë do të të bëjë të lirë.”

Këto kanë qenë fjalët e fundit të cilat Milioneri i ka folur. Përjashta stuhia po ashtu papritmas ishte qetësuar, ashtu siç edhe kishte filluar, dhe dielli përsëri vezullonte. Drita e qirinjve më nuk ishte e nevojshme. Milioneri e ka ngritur shandanin dhe e ka marrë pa asnjë fjalë. Djaloshi nuk ka gjykuar të thoshte çfarëdoqoftë. Ka mbetur vetëm, në kokë i kanë vërshtuar mendimet, gjersa në dorë ka mbajtur paratë të cilat Milioneri ia kishte dhënë.

## KREU 15

### **Djaloshi dhe plaku shkojnë rrugëve të ndryshme**

Djaloshi nuk mbeti kohë të gjatë vetëm. Përnjëherë është lajmëruar shërbëtori, duke bartur kovertën. Ia ka ofruar djaloshtit, duke i sqaruar: “Imzot më ka urdhëruar t’jua dorëzoj këtë. Ka insistuar që këtë ta lexoni i vetëm në dhomën tuaj. Edhe një ditë mund ta kaloni këtu. Atëherë duhet të shkoni. Këto janë dëshirat e zotërisë tim.”

Djaloshi i është falënderuar dhe me kërsëri të madhe për të parë se ç’kishte në kovertë, është kthyr dëgjueshëm në dhomën e vet. Kësaj here, sakaq, ishte mjaft i kujdesshëm që ta lente derën pakëz çelur nga frika se mos përsëri po e mbyllnin.

Është ulur në skajin e krevatit, e ka hapur kovertën me nxitim dhe e ka nxjerrë letrën. Ka qenë e shkruar me dorëshkrim të tejbukur, me ngjyrë të zezë, kurse prej saj është përhapur aroma dehëse e trëndafilin.

“Këto janë dëshirat e mia të fundit”, ka qenë e shkruar. “Po t’i lë të gjithë librat nga biblioteka ime. Do të jenë shumë të dobishme. Mos e bëj gabimin e njëjtë me librat si shumë të tjerë. Disa njerëz besojnë se përmbajtja e librit është plotësisht e pavlerë. Besojnë se ata vetë përsëri e zbulojnë botën. Dhe duke qenë se nuk kanë zënë kurrfarë dobie nga dituria në libra i përsërisin, fatkeqësisht, gabimet

e të parëve të tyre. Ashtu humbasin shumë kohë dhe shumë të holla.

Mos bjerë as në kurthin tjetër – që verbërisht t'i besosh përmbajtjes së librave dhe të lejosh që ato para teje të mendojnë për ty. Me rëndësi është se njerëzit e vyeshëm, autorët e atyre librave, kanë udhëtuar shumë dhe i kanë parë shumë gjëra. Libri është gjithmonë, deri në njëfarë mase, tregim për atë rrugë. Por rruga kah ti shkon nuk është e njëjtë si e tyrja. Ruaje vetëm atë që e mbijeton kohën. Sa u përket të tjerave, shfrytëzoje atë më të vlefshmen që ke: *kokën* tënde. Ajo është, me sa di unë, akoma shpikja më e madhe për të menduar. Për fat të keq, shumë njerëz e harxhojnë jetën duke kërkuar mënyra që thjesht të mos mendojnë. E tillë është natyra njerëzore. E prirur është për zgjidhjet e lehta, së paku në dukje. Me njerëzit kryesisht zotëron natyra dhe instiktet. Ki kujdes që mendja jote të dalë fitimtare.

Që nga takimi ynë i parë kam provuar të t'i bart margaritarët e urtisë të cilët kam arritur t'i mbledh gjatë jetës sime të gjatë. Në këtë dokument do t'i gjesh disa nga mendimet të cilat përfaqësojnë trashëgiminë time shpirtërore. Do të dëshiroja të jepje çdo gjë nga vetja dhe t'ua transmetoje një numri sa më të madh njerëzish. Kështu jeta ime do të kishte kuptim. Iu trergo njerëzve për takimin tonë dhe për të fshehtën të cilën e ke mësuar. Para kësaj, ndërkaq, duhet edhe vetë ta shijosh. Metoda që nuk është e provuar dhe e testuar, plotësisht është e pavlerë. Për gjashtë vjet do të bëhesh milioner. Atëherë do të jesh i lirë për të

ndërmarrë hapat e nevojshëm që t'ua transmetosh trashëgiminë time të tjerëve dhe t'iu flasësh për takimin tonë.

Tash duhet të të lë. Trëndafilat e mi edhe ashtu tepër gjatë më presin.”

Përkundër asaj se emocionet e kanë paralizuar, djaloshi ka ndier se edhe diçka ka në letër – testamenti i Milionerit. Ka qenë në kovertën posaçërisht të madhe, i vulosur me vulën e madhe të kuqe prej dylli në formë trëndafili. Djaloshi kujdesshëm e ka thyer vulën, e ka hapur kovertën dhe e ka nxjerrë dokumentin prej disa faqesh.

Ky dokument i pazakonshëm ka qenë i shkruar me dorë, me shkronja të mëdha madhështore të cilat janë dukur ashtu të frymëzuara sikur po e frymonin njëfarë jete të tyren. Djaloshi plot një orë ka qenë i preokupuar me testamentin, e iu ka dukur se kanë kaluar vetëm disa minuta.

Kur e ka kryer leximin, ka qenë e natyrshme të shkojë e ta falënderojë Milionerin për dhuratën aq të çmueshme. Është kthyer shpejt në dhomën e ndejës. Nuk ka qenë askush. E ka ftuar shërbëtorin. Nuk ka pasur as përgjigje. Pasi që pas stuhisë përsëri ka vezulluar dielli, ka menduar se Milioneri u është kthyer trëndafilave të tij. Ka pasur të drejtë, por plaku u është shoqëruar atyre nga arsye fare të tjera.

Djaloshi ka vrapuar në kopsht duke e kërkuar Milionerin. Befas e ka parë. Mjaft çuditërisht, plaku ka qëndruar shtrirë në mes të rrugës, pranë kaçubës së

trëndafilte. Pranë tij është prehur shandani: vetëm edhe një qiri akoma është ndezur – më i madhi, gjithë të tjerët janë fikur. Në shikim të parë djaloshi ka menduar se Milioneri vetëm po flinte, se përpak ka dremitur në vendin jo të zakonshëm – ka qenë, në fund të fundit, mjaft ekscentrik. Por, sa më tepër i është afruar ka qenë gjithnjë e më i brengosur, sikur ta ndiente se po ndodhte diçka shumë serioze.

Kur përfundimisht i është ofruar Milionerit, frika e tij ka dalur e arsyeshme. Plaku ka qenë i veshur me petk të bardhë solemn i cili i ka arritur gjer tek zokthi i këmbës. Në duart e tij të kryqëzuara mbi gjoks është ndodhur vetëm një trëndafil. Në fytyrën e tij nuk ka pasur as një trohë frikë, as gjurmë vuajtjeje. Ka qenë plotësisht i qetë: ka qenë i vdekur, pikërisht siç nga larg iu duk djaloshit. Është bindur për këtë pasi që është gjunjëzuar mbi të dhe ka vënë veshin te goja e plakut. Më nuk ka frymuar, edhe pse qenia e tij përgjithësisht ka rrezatuar lunturi të mbinatyrshme.

“Sa çuditërisht ka vdekur!” ka klithur djaloshi në vetvete. Milioneri e ka ditur momentin e saktë se kur është dashur të shkojë. Kushedi, ndoshta e ka porositur çastin e saktë të largimit të tij me ndonjëfarë mënyre çuditërisht të fshehtë, të cilën vetëm ai e ka ditur, apo thjesht ka vendosur të vdesë! Djaloshi këtë kurrë nuk ka për ta ditur. Milioneri këtë të fshehtë e ka marrë me vete.

Djaloshi e ka ndier se edhe për të ka ardhur koha e largimit. Këtu më asgjë nuk ka mundur të bëhet. Por, para largimit, ka menduar, ndoshta me vete do të mund ta merrte

trëndafilin e Milionerit për kujtim. Është gërmucur mbi trupin e vdekur dhe e ka zgjatur dorën. E ka prekur trëndafilin, por befas e ka tërhequr dorën, duke vendosur që të mos e merrte. E ka ndier se me këtë do ta përdhoste kujtimin për Milionerin. Ai trëndafil i përkiste atij. Ai ka qenë shoqëria e tij e fundit. Djaloshi është drejtuar dhe shikimi i ka rënë mbi shandanin në të cilin qiriu i mesëm çuditërisht akoma ndizej. Lotët i kanë rënë për tokë. Nuk e kishte njohur Milionerin kohë të gjatë, por aq thellësisht ishte lidhur me të, si ta kishte pasur prind.

Solemnisht, atëherë, në atë vend, është betuar se nuk ka për ta tradhtuar Milionerin; e se ka për ta bartur mësimin e tij në mënyrën më të mirë të mundshme që ai di. Në çastin kur e ka përfunduar betimin e tij solemn edhe qiriu i fundit ishte fikur.

Djaloshi është larguar në mënyrën e njëjtë, ashtu siç ka ardhur, fuqimisht duke e mbajtur dëshirën e fundit të Milionerit dhe testamentin në gjoksin e vet.

Ditën tjetër biblioteka i ka mbërritur në shtëpi. Ka qenë aq e madhe sa që ka mbetur fare pak vend për gjëra të tjera. Në të vërtetë, para djaloshit menjëherë ka shkrepur dilema: ose për t'u shpërngulur ose për t'i larguar disa libra. E ka zgjedhur shpërnguljen. Dhe këtë e ka bërë me zemër të lehtë. A nuk ka qenë, vallë, kjo shenjë e jetës së re që po fillonte?

## **EPILOG**

Ashtu siç Milioneri edhe e pati paraparë, djaloshi milionin e tij të parë e arriti para afatit të caktuar prej gjashtë vjetësh. Kështu që e mbajti premtimin. E mori një muaj të lirë për të shkruar për takimin e tij me Milionerin dhe për filozofinë të cilën ai ia kishte mësuar.



# TREGIM PËR URTINË DHE PASURIMIN

“**Milioneri**” e zbulon të fshehtë të suksesit të përgjithshëm dhe finaciar.

Duke lexuar tregimin e tij, keni për ta kuptuar se ju mund ta kontrolloni fatin tuaj.

Lirojeni fuqinë tuaj të brendshme dhe shihni sesa është reale ajo që Milioneri rekomandon:

*“Trëndafili prejgjithmonë ka qenë simbol i jetës. Nëse arrin ta kontrollosh mendjen tënde, ke për ta kuptuar pse. Gjembu paraqet rrugën gjer te përvoja: të gjithë duhet të kalojmë nëpër tundime e vuajtje për ta kuptuar bukurinë e ekzistencës.”*